

MBIKËQYRJA PARLAMENTARE DHE FUNKSIONI ZGJEDHOR 2024

GJETJE DHE REKOMANDIME



Raportimi në Kuvend për veprimtarinë vjetore dhe zgjedhja/emërimi
në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj nga
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

(Vështrim krahasues me procesin e vitit 2023)



MBIKËQYRJA PARLAMENTARE DHE FUNKSIONI ZGJEDHOR 2024

GJETJE DHE REKOMANDIME

Raportimi në Kuvend për veprimtarinë vjetore dhe zgjedhja/emërimi
në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj nga
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

(Vështrim krahasues me procesin e vitit 2023)

Korrik 2024



British Embassy
Tirana



WFD



Ky raport realizohet në kuadër të projektit “Rritja e llogaridhënies së qeverisë përmes një Parlamenti më reagues”, i cili po realizohet nga Fondacioni Westminster për Demokracinë (WFD) me mbështetjen financiare nga Ambasada Britanike në Tiranë. Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD- së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

Realizoi

Instituti i Studimeve Politike (ISP)

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

E-mail: contactaips@isp.com.al

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr. “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

PËRMBAJTA

AKRONIME DHE SHKURTESA.....	5
PJESA E PARË: RAPORTIMI NË KUVEND I INSTITUCIONEVE TË PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË KRIJUARA ME LIGJ PËR VEPRIMTARINË E TYRE VJETORE 2023.....	7
HYRJE.....	9
1.PROCESI RAPORTUES NË KUVEND.....	12
1.1. DEPOZITIMI I RAPORTIT VJETOR NË KUVENDIN E RSH-SË, RESPEKTIMI I AFATIT LIGJOR PËR DEPOZITIM.....	12
1.2. RESPEKTIMI I KËRKESAVE LIGJORE DHE UDHËZIMEVE TË KUVENDIT MBI STRUKTURËN DHE PËRMBAJTJEN E RAPORTIT VJETOR.....	13
1.3. VLERËSIMI I VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT NË MONITORIM NGA KOMISIONI PËRGJEGJËS PARLAMENTAR.....	15
1.3.1. PËRFSHIRJA E SHOQËRISË CIVILE.....	16
1.3.2. PARAQITJA E RAPORTIT NGA TITULLARI I INSTITUCIONIT TË PAVARUR.....	18
1.3.3. ANALIZIMI DHE VLERËSIMI I RAPORTIT VJETOR NGA SHËRBIMI I MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE DHE RELATORI.....	19
1.3.4. ANGAZHIMI I DEPUTETËVE NË KOMISION.....	20
1.3.5. TRAJTIMI I PROBLEMATIKAVE TË INSTITUCIONEVE NË MONITORIM.....	21
1.3.6. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE/ PLATFORMA NDËRINSTITUCIONALE.....	24
1.3.7. RAPORTI I KOMISIONIT PËR PROCESIN RAPORTUES TË INSTITUCIONIT NË MONITORIM.....	25

2.SHQYRTIMI NË SEANCË PLENARE.....	26
2.1. ANGAZHIMI I DEPUTETËVE NË VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT NË MONITORIM	26
3.MIRATIMI I REZOLUTËS PËR INSTITUCIONIN NË MONITORIM	26
4. KONKLuzion.....	27
5. REKOMANDIME.....	28
PJESA E DYTË: ZGJEDHJA/EMËRIMI NË ORGANET KUSHTETUESE OSE TË KRIJUARA ME LIGJ NGA KUVENDI I REPUBLIKËSSËSHQIPËRISË.....	31
HYRJE.....	33
1.PROCESI PARAPRAK NË INSTITUCIONIN PROPOZUES.....	35
1.1. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE PËR SHPALLJEN E VENDIT VAKANT.....	35
1.2. ZHVILLIMI I PROCESIT PARAPRAK PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE TË VETOFRUARA, NDËRVEPRIMI ME SHOQËRINË CIVILE.....	39
1.3. DËRGIMI I KANDIDATURAVE PËR SHQYRTIM NË ORGANIN E EMËRTESESË (KUVENDIN E RSH)/ DOKUMENTACIONI SHOQËRUES DHE AFATI LIGJOR PËR PARAQITJEN E TIJ NË KUVEND.....	42
2.PROCESI ZGJEDHËS/EMËRUES NË ORGANIN E EMËRTESESË- KUVEND.....	44
2.1. NJOFTIMI NË SEANCË PLENARE I DEPOZITIMIT NË KUVEND TË PROPOZIMIT PËR ZGJEDHJE/EMËRIM NË INSTITUCIONET E PAVARURA.....	44
2.2. NJOHJA PUBLIKE ME PËRVOJËN PROFESIONALE TË KANDIDATURAVE.....	44
2.3. SHQYRTIMI I KANDIDATURAVE NGA KOMISIONI PËRGJEGJËS PARLAMENTAR.....	46
2.4. SHQYRTIMI I KANDIDATURAVE NË SEANCË PLENARE.....	49
3. KONKLuzion.....	51
4. REKOMANDIME.....	52

AKRONIME DHE SHKURTESA

Nr.	Shkurtesa	Emri i plotë
1	AIDSSH	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit
2	AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
3	AK/KK	Autoriteti i Konkurrencës/Komisioni i Konkurrencës
4	AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
5	AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
6	AP	Avokati i Popullit
7	ASD	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
8	BE	Bashkimi Evropian
9	BSH	Banka e Shqipërisë
10	CRCA	Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri
11	EP	Ekipi Përzgjedhës
12	ERRE	Enti Rregullator i Energjisë
13	ERRU	Enti Rregullator i Ujërave
14	GJK	Gjykata Kushtetuese
15	ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
16	ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe i Konfliktit të Interesit
17	INSTAT	Instituti i Statistikave
18	IPU	Unioni Ndërparlamentar
19	ISKPKSH	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri

20	KÇLAPDNJ	Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
21	KE	Komisioni Evropian
22	KEF	Komisioni për Ekonominë dhe Financat
23	KEMIP	Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
24	KDRTSH	Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar
25	KDIMDHP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
26	KM	Këshilli i Ministrave
27	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
28	KMBSH	Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë
29	KLQJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
30	KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
31	KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
32	KMSHC	Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil
33	KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
34	KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
35	KS	Këshilli i Statistikave
36	KSHH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
37	KVPTM	Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
38	OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
39	PP	Prokurori i Përgjithshëm
40	SPAK	Prokuroria e Posaçme
41	SHMI	Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura në Kuvend
42	TI	Lëvizja Transparenca Ndërkombëtare

MBIKËQYRJA PARLAMENTARE
DHE FUNKSIONI ZGJEDHOR
2024

PJESA E PARË:
RAPORTIMI NË KUVEND I INSTITUCIONEVE
TË PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË KRIJUARA
ME LIGJ PËR VEPRIMTARINË E TYRE
VJETORE 2023

HYRJE

Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (në vijim Kuvendi), përveç funksionit parësor të miratimit të ligjeve, i atribuohet me Kushtetutë edhe funksioni i kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky funksion i rëndësishëm, ushtrohet duke respektuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe ka në thelb kërkesën e llogarisë ndaj institucioneve publike. Roli kontrollues dhe mbikëqyrës përqendrohet kryesisht mbi Qeverinë karakteristike për një sistem parlamentar të sanksionuar me kushtetutë sipas së cilës, Qeveria buron dhe merr mandatin nga parlamenti duke iu nënshtruar njëkohësisht kontrollit parlamentar. Kontrolli ngërthen edhe disa institucione të pavarura kushtetuese e të krijuara me ligj, të cilat bartin detyrimin kushtetues dhe ligjor për raportim në Kuvend.

Kuvendi, si organi më i lartë përfaqësues dhe mbartës i sovranitetit të popullit, ka përgjegjësinë kushtetuese dhe ligjore për të siguruar llogaridhënien ndaj ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura. Llogaridhënia është e domosdoshme për shkak të rolit të tyre në jetësimin e interesit publik dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të qytetarëve. Ajo konsiderohet si një ndër vlerat themelore, nga të cilat Kuvendi udhëhiqet në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij¹.

¹ Shih Planin Strategjik të Kuvendit për vitet 2020-2025 në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20211025114206vendimi%20dhe%20plani%20strategjik.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 12.05.2024)

Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit dhe ligje organike parashikojnë detyrimin e 26 institucioneve kushtetuese² dhe të krijuara me ligj³, që të raportojnë në Kuvend lidhur me veprimtarinë e tyre vjetore pararendëse dhe shkallën e përmbushjes së objektivave të ngarkuara nga ligji. Ky kuadër ofron bazën ligjore, që Kuvendi të ushtrojë mandatin e tij kushtetues për mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe këtyre institucioneve. Raportimi është një mekanizëm i domosdoshëm me anë të së cilit Kuvendi përmbush rolin mbikëqyrës ndaj tyre. Përmes këtij mekanizmi kushtetues/ligjor krijohet një marrëdhënie e varësi e ndërsjellë llogaridhënëse Kuvend-institucione të pavarura duke i dhënë të drejtën, (por edhe detyrimin) Kuvendit, që të monitorojë dhe vlerësojë performancën e tyre. Duke qenë se kuadri kushtetues dhe ligjor e garanton detyrimin për llogaridhënie, një nga sfidat mbetet arritja e nivelit të duhur të saj. Fuqizimi i mëtejshëm i ushtrimit të këtij funksioni është një ndër objektivat e Kuvendit për periudhën 2020-2025 e parashikuar në Planin Strategjik të tij⁴.

Instituti i Studimeve Politike (në vijim ISP), në kuadër të projektit “Rritja e llogaridhënies së qeverisë përmes një parlamenti më reagues”, i cili po realizohet nga Fondacioni Westminster për Demokracinë (WDF) me mbështetjen financiare nga Ambasada Britanike në Tiranë, nga analiza e bërë në punimin e vitit 2023 lidhur me procesin raportues vjetor në Kuvend të këtyre institucioneve evidentoi një sërë problematikash të lidhura ngushtë si me llogaridhënien e institucioneve në monitorim, ashtu edhe me mbikëqyrjen e Kuvendit karshi tyre.

Paraqitja e raportit vjetor në Kuvend përtej afatit ligjor të përcaktuar dhe jo në pajtim me udhëzimet e Kuvendit, llogaridhënia formale dhe mbikëqyrje joefikase parlamentare, mungesa e një analize profesionale në vlerësimin e raportit vjetor, mospërfshirja e shoqërisë civile në këtë proces, si dhe mungesa e mekanizmave përcjellës në platformën ndërinstitucionale për monitorimin e ecurisë dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna⁵ ishin disa nga problematikat e hasura.

2 Këshilli i Ministrave, Avokati i Popullit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Banka e Shqipërisë, Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Prokuroria e Posaçme. (Shënim: Mbikëqyrja parlamentare ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë, në përputhje të plotë me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ka të bëjë me performancën e institucioneve dhe jo me vendimet e magjistratëve).

3 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe i Konfliktit të Interesit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Enti Rregullator i Energjisë Elektrike, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunitetit në Shqipëri, Enti Rregullator i Ujërave, Komisioni i Prokurimit Publik, Instituti i Statistikave.

4 Shih Planin Strategjik të Kuvendit për vitet 2020-2025 në linkun <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20211025114206vendimi%20dhe%20plani%20strategjik.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 12.05.2024)

5Rekomandime të Kuvendit për institucionet e pavarura si dhe rekomandime të disa të institucioneve të pavarura drejtuar ekzekutivit dhe njësisë të varësisë.

Në vijim të problematikave ISP paraqiti rekomandimet përkatëse, të cilat synojnë forcimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes parlamentare ndaj institucioneve të pavarura. Përmirësimi i llogaridhënies së institucioneve të pavarura dhe i mbikëqyrjes parlamentare ndaj tyre arrihet duke shfrytëzuar me efektivitet të gjithë mekanizmat kushtetues dhe ligjorë, në mënyrë sistematike, të qartë dhe rigoroze dhe duke përfshirë sigurimin e monitorimit sistematik të rekomandimeve dhe ndjekjen e tyre.

ISP po vazhdon të monitorojë procesin raportues dhe në kuadër të projektit ka realizuar raportin monitorues për procesin raportues 2024. Qëllimi i këtij raporti është të shërbejë si mjet i pavarur për vlerësimin e procesit raportues në Kuvend duke u fokusuar në identifikimin e përmirësimeve të mundshme, si rezultat i rekomandimeve të dhëna vitin paraardhës (raporti 2023), dhe në dhënien e rekomandimeve të tjera se çfarë mund të përmirësohet në drejtim të këtij procesi. Raporti, nën dritën e një këndvështrimi krahasues, analizon të gjitha fazat e procesit për të evidentuar problematikat dhe gjetjet pozitive në secilën prej tyre.

1. PROCESI RAPORTUES NË KUVEND

1.1. DEPOZITIMI I RAPORTIT VJETOR NË KUVENDIN E RSH-SË, RESPEKTIMI AFATIT LIGJOR PËR DEPOZITIM

Ligjet organike parashikojnë afatin brenda të cilit institucionet në monitorim duhet të paraqesin në Kuvend raportin për veprimtarinë e tyre vjetore pararendëse. Në respektim të dispozitave ligjore dhe rregullave të procedurës Kuvendi miraton çdo fillim viti kalendarin vjetor për raportimin e institucioneve të pavarura duke përcaktuar datën 31 mars si afatin maksimal të depozitimit të raportit në Kuvend⁶.

Ndonëse të gjitha institucionet kanë depozituar në Kuvend raportin vjetor, referuar faqes së Kuvendit në internet rezulton se një pjesë e konsiderueshme e institucioneve i kanë depozituar përtej afatit të përcaktuar, konkretisht: KLGJ, KLP, AP, ISKPKSH, INSTAT, KPP, ERRE, ILDKPKI, AIDSSH, KMD, KDRTSH⁷. Kjo dëshmon mungesë përgjegjësie nga ana e institucionit në monitorim, njëkohësisht mbikëqyrje joefektive parlamentare. Problematika është identifikuar edhe gjatë procesit raportues 2023, për zgjidhjen e së cilës ISP rekomandoi parashikimin e masave ndëshkuese për institucionet⁸.

Nga ana tjetër, vlerësohet i nevojshëm rishikimi i afatit maksimal të depozitimit të raporteve për disa institucione si p.sh. AMF, AP, KLGJ, KLP etj. Referuar ligjit organik raporti vjetor i veprimtarisë së AMF-së duhet të shoqërohet edhe me pasqyrat financiare të audituara të subjekteve mbikëqyrëse (kompanive të sigurimit), proces i cili, referuar ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", bëhet brenda muajve prill dhe maj. Afati i vendosur nga Kuvendi detyron institucionin për ta paraqitur raportin vjetor me të dhëna të paaudituar⁹. Gjithashtu referuar ligjit organik të AP-së, KLGJ-së, KLP-së etj. raporti duhet të paraqitet në Kuvend jo më vonë se data 30 prill apo 1 maj i vitit në vijim.

6 Neni 103 Rregullore Kuvendi. Pas miratimit në Konferencën e Kryetarëve kalendari u njoftohet deputetëve në seancë plenare dhe publikohet. Shih kalendarin vjetor të raportimeve në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202401160807108289KALENDARI%20VJETOR%20I%20KUVENDIT%20P%C3%8B%20RAPORTIMIN%20E%20INSTITUCIONEVE%20T%C3%8B%20PAVARURA%20P%C3%8B%20VEPRIMTARIN%20E%20VITIT%202023%20DHE%20USHTRIMIN%20E%20KONTROLLIT%20PARLAMENTAR%20T%C3%8B%20KOMISIONEVE%20P%C3%8B%20VITIN%202024.pdf>

(Aksesuar për herë të fundit më 04.05.2024)

7Shih datën e depozitimit në linket përkatëse të publikimit të raporteve si dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit për periudhën 29 prill - 18 maj 2024 në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404301358544463Kalendari%20i%20punimeve%20t%C3%AB%20Kuvendit%20p%C3%AB%20periudh%C3%ABn%2029%20prill%20-%2018%20maj%202024.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 04.05.2024)

8Tërheqje vëmendjeje ose vërejtjeje. P.sh. Kryetari i Kuvendit në formë shkresore i bën me dije organit drejtues të institucionit të pavarur masën disiplinore të ndërmarrë.

9 Shih mbledhjen e komisionit për Ekonominë dhe Financat të datës 15.05.2024 në linkun <https://www.parlament.al/live-vod>

1.2. RESPEKTIMI I KËRKESAVE LIGJORE DHE UDHËZIMEVE TË KUVENDIT MBI STRUKTURËN DHE PËRMBAJTJEN E RAPORTIT VJETOR

Institucionet e pavarura, që monitorohen nga Kuvendi mbartin detyrimin e hartimit të raportit vjetor konform udhëzimeve të parashikuara në ligjin organik, Manualin “Për monitorimin vjetor dhe periodik” dhe Manualin “Për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen Parlamentare”. Kërkesat ligjore mbi strukturën dhe përmbajtjen e raportit vjetor janë një tregues i rëndësishëm i nivelit të llogaridhënies. Performanca e institucioneve të pavarura fillimisht vlerësohet në aspektin e pajtueshmërisë së raportit me udhëzimet e Kuvendit dhe kërkesat ligjore. Nëse raporti vjetor përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për vlerësim të performancës, atëherë ky raport vazhdon të analizohet dhe vlerësohet në bazë të përmbajtjes së tij. Nga monitorimi i kryer rezulton se disa institucione si PP, ILDKPKI, ILD, KPP, AMF, KMD, KMSHC, AMA etj kanë depozituar raportin vjetor jo konform udhëzimeve.

Ndonëse një nga kërkesat për raportim është edhe nevoja për ndryshime në kuadrin ligjor, që rregullon veprimtarinë e institucionit ose në akte normative detyruese për institucionin, PP nuk ka informuar në lidhje me nevojën për ndryshime në ligjin për dekriminalizimin¹⁰ dhe në ligjin për arkivat¹¹, ILDKPKI për ndryshime në ligjin e konfliktit të interesave¹² dhe ligjin e sinjalizuesve¹³, KMD për ligjin organik¹⁴, AMA për ligjin organik¹⁵ etj.

10 Nga analiza e ligjit 138/2015 (dekriminalizimi) dhe monitorimit të jetësimit të tij në praktikë, por edhe referuar tryezave konsultative me aktorë të ndryshëm (institucionet, partitë apo ekspertët) rezulton se legjislati dhe aktet nënligjore kanë disa problematika që krijojnë debat dhe që përdoren nga institucionet apo subjektet për të evituar jetësimin me standarde të larta të dekriminalizimit. Shih <https://www.reporter.al/2021/07/05/ekspertet-kerkojne-rishikim-te-ligjit-te-dekriminalizimit/> <https://www.zeriamerikes.com/a/5845846.html>

11 PP ka nevojë imediate për ndryshime në ligjin për arkivat si dhe për marrjen e masave ndër-institucionale për sigurim të infrastrukturës që do të mundësojë ruajtjen e dokumentacionit.

12 ILDKPKI e ka të domosdoshme ndërhyrjen në kuadrin ligjor të konfliktit të interesave për të fuqizuar rregullat e konfliktit të interesit në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna nga GRECO në raportin e përputhshmërisë (raundi i V i vlerësimit, viti 2022). Shih raportin e përputhshmërisë, raundi i V i vlerësimit për Shqipërinë, fq. 5 në linkun <https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6124> (Aksesuar për herë të fundit më 05.05.2024)

13 Nevoja për ndryshime ligjore ka qenë objekt tryezash dhe diskutimesh. Shih Analiza e boshllëqeve të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve të Shqipërisë - Iniciativa Rajonale kundër Korrupsionit 2021 në linkun https://rai-see.org/php_sets/uploads/2021/10/RAI-GAP-Analysis-excerpt-Albania.pdf

14 Raporti i KE (nëntor 2023) për Shqipërinë për shqyrtimin analitik (Screening) për grup-kapitujt 1, (Themelorët) nënvizon se “Për të fuqizuar Komisionerin të lëshojë urdhra ekzekutivë në vend të rekomandimeve nevojiten të bëhen ndryshime në ligj”.

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404041324018899Albania%20report%202023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 12.05.2024)

15 Për sa u takon faqeve të paregjistruara (faqeve on-line).

Ka mungesë raportimi për zbatimin e Kodit të Sjelljes (në veçanti nga Bordet për rastet e konfliktit të interesit) dhe për përpjekjen e institucioneve në monitorim për t'i përmirësuar ato. Kjo duhet trajtuar me vëmendje nga institucioni mbikëqyrës (Kuvendi), pasi Kodet e Etikës konsiderohen si një nga indikatorët e llogaridhënies¹⁶. Nuk ka asnjë raportim për raste të mundshme të konfliktit të interesave në vendimmarrje gjë që ngre dyshime të forta në lidhje me efektivitetin e zbatimit të ligjit.

- ILDKPKI vijon të raportoje për zbatimin e ligjit për sinjalizuesit brenda raportit vjetor ndërkohë që duhet ta trajtojë më gjerësisht këtë me raport të veçantë¹⁷ si dhe raporton vetëm në shifra për çështjet e adresuara në prokurori pa përmendur funksionet përkatëse të personave të kallëzuar si dhe ndjekjen e tyre (kallëzimeve).
- AMF ndonëse ka shënuar progres me miratimin e kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit për tregjet e kapitalit, nuk ka raportuar për ankimet ndaj vendimeve të Bordit si dhe për rezultatet e detajuara të inspektimeve si një ndër kërkesat për raportim.
- AMA nuk ka informacion për çështjet gjyqësore të humbura.
- KLSH jep vetëm shifra dhe nuk identifikon institucionet që rezultojnë me nivelin më të ulët të treguesit të zbatimit të rekomandimeve, megjithëse kjo ka qenë një prej rekomandimeve të lëna nga Kuvendi¹⁸ nuk ka informacion rreth metodologjisë së ndjekur në llogaritjen e dëmit ekonomik, që i shkaktohet buxhetit të shtetit¹⁹, informon për burimet njerëzore, por nuk jep informacion për arsyet e mosplotësisimit të vendeve vakante në administratë, ka mungesë informacioni lidhur me ndjekjen e çështjeve të adresuara në prokurori. Ka raporte të cilat janë voluminoze e me shifra që vetëm krijojnë konfuzion dhe vështirësi për t'u kuptuar.

16Shih De Vrieze F. (2011) në "Independent oversight institutions and regulatory agencies, and their relationship to parliament", WFD (Westminster Foundation for Democracy), London February 2019, faqe 26-33 aksesuar për herë të fundit më 18.05.2024 <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/independent-oversight-institutions-and-regulatory-agencies-and-their>

17 Paraqitja e të dhënave në mënyrë më të plotë, të detajuar dhe profesionale (me raport të veçantë) krijon një tablo më të qartë për rezultatet e zbatimit të ligjit, natyrën e rasteve të sinjalizuara, masat e marra nga ky institucion (në veçanti për mbrojtjen e sinjalizuesve) dhe referimin organeve kompetente për trajtim të mëtejshëm. Kjo rrit besimin e publikut tek ky institucion si dhe tek mekanizmat e ligjit.

18Raporti vjetor përmend dërgimin e dy raporteve të veçanta në Kuvend dhe përditësimin e Platformës Ndërinstitucionale që administrohet nga Kuvendi, por që këto raporte nuk janë publikuar ndërsa kategoria e rekomandimeve në këtë Platformë është e paaksesueshme për publikun.

19 Përcaktimi i një metodologjie në përlllogaritjen e dëmit ekonomik, që i shkaktohet buxhetit të shtetit duke iu referuar praktikave më të mira ka qenë një prej rekomandimeve të lëna për KLSH në vitin 2023, por KLSH raporton se në praktikën e mira nuk ekziston një metodologji e tillë. Pavarësisht kësaj, KLSH duhet të informojë se çfarë metodologjie përdor ai si institucion për të llogaritur dëmin ekonomik.

- Në këtë kontekst është i nevojshëm trajnimi nga Kuvendi (SHMI) i stafeve përkatëse të institucioneve në monitorim, me qëllim hartimin e një raporti profesional, të shkurtër, efikas, të plotë e të kuptueshëm, si dhe komunikim i vazhdueshëm dhe intensiv i tyre (stafeve) gjatë gjithë vitit.

Për sa më sipër, nga të dhënat monitoruese rezulton se institucionet nuk u përmbahen udhëzimeve të Kuvendit. Për këtë problematikë të përvitshme ISP sugjeroi kthimin e raportit tek institucioni në monitorim për plotësimet e nevojshme përpara raportimit në komision. Rezulton se Kuvendi është pajtuar me përmbajtjen e raporteve vjetore problematike pa i penalizuar qoftë edhe me masa institucionale. Ato janë pranuar nga komisioni përgjegjës parlamentar, i cili në lidhje me mungesën e çështjeve për të cilat institucioni duhej të raportonte ose i ka kaluar në heshtje²⁰, ose është mjaftuar me një evidentim nga relatori në mbledhjen e komisionit²¹. Kjo dëshmon mungesë vullneti për transparencë dhe llogaridhënie dhe njëkohësisht mbikëqyrje parlamentare joefektive. Procedurat e kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare kërkojnë domosdoshmërisht reagime dhe vendime nga Kuvendi, që kjo mbikëqyrje të konsiderohet efikase. Kjo ndikon tek besimi i publikut në institucionin ligjvënës.

1.3. VLERËSIMI I VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT NË MONITORIM NGA KOMISIONI PËRGJEGJËS PARLAMENTAR

Sistemi i komisioneve është instrumenti parësor, që ka një parlament për të ushtruar funksionin kontrollues dhe mbikëqyrës ndaj institucioneve të pavarura. Menjëherë pas depozitimit në Kuvend të raporteve vjetore, komisionet e përhershme, mbi bazën e kalendarit vjetor, miratojnë kalendarët e tyre të punës, në të cilat parashikohen seancat dëgjimore për çdo institucion. Një planifikim paraprak u jep të gjithë kohën e nevojshme deputetëve për t'u njohur me raportin, evidentuar problematikat dhe për të përgatitur pyetjet. Referuar dokumentacionit parlamentar në faqen e Kuvendit²² procesi raportues për vitin 2024 në këto komisione, ka startuar më 2 prill 2024 me raportimin në KVPTM të ERRU-t²³ dhe ka përfunduar datë 26 korrik me raportimin në seancë plenare të AMA-s. Ndërkohë KLSH rezulton të ketë raportuar në KEF dhe ende në seancë plenare.

20 P.sh. për shqyrtimin e raporteve vjetore të AMF, KPP. Shih mbledhjen e komisionit për Ekonominë dhe Financat dhe komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për shqyrtimin e raportit vjetor të AMF dhe KPP në linkun <https://www.parlament.al/live-vod>

21 P.sh. për shqyrtimin e raportit vjetor të ILD, ILDKPKI, KMSHC, KMD etj.

22 Shih: kalendarët e punimeve në komisione, rendin e ditës së komisioneve si dhe mbledhjet e komisioneve live.

23 Shih procesverbalin e komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404171122087299Procesverbal%20dat%C3%AB%2002.04.2024.pdf>

Institucionet e pavarura kanë raportuar vetëm në 4 komisione duke qenë se këto të fundit mbulojnë fushën e veprimtarisë së tyre, konkretisht: 14 institucione në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut²⁴, 6 institucione në Komisionin për Ekonominë dhe Financat²⁵, 3 institucione në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin²⁶ dhe 3 institucione në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik²⁷.

Raportimi i institucioneve të pavarura në Kuvend ka qenë edhe në fokus të mediave, të cilat kanë informuar publikun duke kontribuar në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së qeverisjes. Nga ana tjetër edhe Kuvendi ka pasqyruar këtë veprimtari në faqen e tij zyrtare në internet dhe ka mundësuar transmetimin e mbledhjeve të komisioneve në faqen e tij. Gjithashtu, raportimet e drejtuesve të institucioneve të sistemit të drejtësisë si ILD, KLGJ, SPAK janë ndjekur edhe nga përfaqësues të OPDAT²⁸, Zyrës së Delegacionit të BE-së, ICITAP²⁹, EU4Justice³⁰ etj.

1.3.1. PËRFSHIRJA E SHOQËRISË CIVILE

Referuar Planit Strategjik të Kuvendit, llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja, janë sanksionuar si ndër vlerat themelore, nga të cilat Kuvendi udhëhiqet në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij³¹. Në këtë kontekst dhe në kuadër të procesit të konsultimit të jashtëm, me qëllim respektimin e parimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes, Kuvendi ka përfshirë në platformën e konsultimit publik raportet vjetore të institucioneve të pavarura me qëllimin e tërheqjes së komenteve, mendimeve dhe sugjerimeve të OSHC për përmbajtjen e tyre.

Kjo është përpjekja e parë e Kuvendit për të përfshirë mendimin e shoqërisë civile në mbikëqyrjen parlamentare ndaj institucioneve të pavarura dhe vjen në zbatim të

24Në këtë komision raportojnë: Këshilli i Ministrave (Ministri përgjegjës për Administratën Publike (DAP), Avokati i Popullit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Prokuroria e Posaçme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe i Konfliktit të Interesit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Komisioni i Prokurimit Publik.

25Në këtë komision raportojnë: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Instituti i Statistikave.

26 Në këtë komision raportojnë: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Enti Rregullator i Energjisë Elektrike, Enti Rregullator i Ujërave.

27Në këtë komision raportojnë: Autoriteti i Mediave Audiovizive, Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar dhe Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pashëve të Komunizmit në Shqipëri.

28 The Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training

29 International Criminal Investigative Training Assistance Program

30The European Union Agency for Criminal Justice Cooperation

31Shih Planin strategjik të Kuvendit 2020-2025 miratuar me vendimin nr. 56/2021 të Kuvendit. <https://web-api.parlament.al/Files/20211025114206vendimi%20dhe%20plani%20strategjik.pdf> Aksesuar për herë të fundit më 03.05.2024

planit të veprimit të masave për adresimin e rekomandimeve që i adresohen Kuvendit nga raporti i KE për shqyrtimin analitik (screening) për grup-kapitujt 1, (Themelorët)³².

Përfshirja e shoqërisë civile në këtë proces ka qenë një prej rekomandimeve të dhëna nga ISP në vitin 2023. Sikurse thekson edhe KE, mbikëqyrja parlamentare ndaj këtyre institucioneve ka nevojë për fuqizim të mëtejshëm³³ dhe në këtë kontekst shoqëria civile është një aktor shumë i rëndësishëm për të arritur në mbikëqyrje efektive. Përfshirja e aktorëve të shumtë e bën procesin më cilësor dhe më transparent.

Hapja dhe transparenca janë thelbësore për krijimin e llogaridhënies. Llogaridhënia fuqizohet nëse performanca e institucionit të pavarur vlerësohet nga jashtë. Sikurse ka theksuar edhe Transparency International OShC-të mund të monitorojnë veprimtarinë e institucioneve të pavarura për të siguruar që raportet e tyre të jenë të paanshme dhe mund të përdoren nga deputetët për funksionin e tyre mbikëqyrës (për shembull, shqyrtimi i politikave)³⁴. Rritja e përfshirjes dhe ndonjëherë presioni nga shoqëria civile mund të kontribuojnë në përmirësimin e performancës së institucioneve të pavarura³⁵.

Pavarësisht progresit, në aspektin e përfshirjes së shoqërisë civile në mbikëqyrjen parlamentare karshi institucioneve të pavarura, mbetet e paqartë se cilat OSHC³⁶ kanë analizuar performancën e institucioneve të pavarura, komentet apo rekomandimet që kanë paraqitur në platformën e konsultimit publik, nëse këto komente kanë gjetur trajtim gjatë mbikëqyrjes në komision dhe nëse kanë gjetur reflektim në rezolutën drejtuar institucionit³⁷.

32Shih Planin e Veprimit të masave për adresimin e rekomandimeve që i adresohen Kuvendit nga Raporti i Komisionit Evropian për Shqyrtimin Analitik (Screening) për grup-kapitujt 1, (Themelorët) miratuar nga Konferenca e Kryetarëve me vendimin nr. 3, datë 21.02.2024 në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202401121551121256Plani%20i%20veprimit%20per%20adresimin%20e%20rekomandimeve%20p%C3%ABr%20Kuvendin%20nga%20Raporti%20i%20Shqyrtimit%20Analitik%20%28Screening%29%20%20per%20cluster%201.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 25.04.2024)

33Shih Raporti KE për shqyrtimin analitik (Screening) për grup - kapitujt 1, (Themelorët) në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404041324018899Albania%20report%202023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 05.05.2024)

34Shih Civil Society Interventions to Enhance Parliamentary Oversight – Transparency International 2022. <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/kproducts/CSO-interventions-to-enhance-parliamentary-oversight.pdf> fq. 10 cit. (Aksesuar për herë të fundit më 05.05.2024)

35De Vrieze F. (2011) "Independent oversight institutions and regulatory agencies, and their relationship to parliament", WFD (Westminster Foundation for Democracy), London February 2019, fq. 29. (Aksesuar për herë të fundit më 02.05.2024) <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/independent-oversight-institutions-and-regulatory-agencies-and-their>

36 Në raportimin vjetor të PP-së përmendet se ka komente për këtë institucion nga ISP, CRCA (Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri) dhe KSHH (Komiteti Shqiptar i Helsinkit), ndërsa në raportimin vjetor të SPAK-ut përmendet se ka rekomandime për këtë institucion nga KSHH, në rastin e ILDKPKI kërkohet dorëzimi me shkrim i përgjigjeve për komentet e ISP-së. Nuk përmenden raste të tjera.

37Në rezolutën për SPAK ka gjetur trajtim rekomandimi i KSHH për t'u kushtuar vëmendje krimeve zgjedhore, veçanërisht fakteve të bëra publike në media para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor, për të filluar hetimin krye sisht në rastet kur ka njoftime publike për kryerjen e një vepre penale. Në rezolutën për PP ka gjetur trajtim rekomandimi i CRCA në lidhje me krimet në internet. Mungon informacioni për komente të tjera të mundshme.

Gjithashtu ngrihen pikëpyetje mbi shkallën e angazhimit të shoqërisë civile në procesin mbikëqyrës parlamentar.

Në këtë kontekst, Kuvendi gjatë procesit të konsultimit publik duhet të bazohet jo vetëm në parimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe mosdiskriminimit në pjesëmarrje, por mbi të gjitha në parimin e transparencës. Në respektim të këtij parimi, Kuvendi, duhet të bëjë transparent çdo mendim/sugjerim/rekomandim/shqetësim të OSHC-ve pjesëmarrëse në konsultimin publik, të informojë publikun në mënyrë efektive mbi to si dhe t'i trajtojë plotësisht këto rekomandime. Vetëm në këtë mënyrë garantohet angazhimi i vërtetë, kuptimplotë dhe joformal i OSHC-ve në këtë proces. Progres raporti i KE (2023) për Shqipërinë ka vënë në dukje sfida të vazhdueshme në zhvillimin e bashkëpunimit të Kuvendit me shoqërinë civile dhe ka rekomanduar nevojën e përfshirjes së shoqërisë civile në vendimmarrje në mënyrë të vazhdueshme, intensive dhe joformale³⁸. ISP vlerëson të nevojshme pjesëmarrjen e shoqërisë civile në seancat dëgjimore mbikëqyrëse me institucionet e pavarura. Prania e saj rrit llogaridhënien e këtyre institucioneve dhe fuqizon mbikëqyrjen parlamentare karshi tyre.

1.3.2. PARAQITJA E RAPORTIT NGA TITULLARI I INSTITUCIONIT TË PAVARUR

Vlerësimi i performancës është vendimtar për të përligjur plotësisht përgjegjësinë, misionin dhe ekzistencën e institucionit në monitorim dhe është konsideruar një nga instrumentet e llogaridhënies³⁹. Paraqitja e raportit nga titullari i institucionit në komisionin përkatës parlamentar në një seancë dëgjimore rrjedh nga detyrimi kushtetues dhe/ose ligjor në funksion të llogaridhënies dhe transparencës publike. Llogaridhënia nënkupton detyrimin për të raportuar, për të shpjeguar, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për t'u përballur me pasojat e mënyrës se si institucioni ka kryer detyrat, si ka përmbushur funksionet dhe si ka shfrytëzuar burimet e tij⁴⁰. Në këtë aspekt, kuadri rregullator nuk parashikon masa ndëshkuese ndaj titullarëve të institucioneve kur performanca e tyre në drejtimin e institucionit është e dobët.

38Shih Raporti KE për shqyrtimin analitik (Screening) për grup - kapitujt 1, (Themelorët) në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404041324018899Albania%20report%202023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 05.05.2024)

39De Vrieze F. (2011) në "Independent oversight institutions and regulatory agencies, and their relationship to parliament", WFD (Westminster Foundation for Democracy), London February 2019, faqe 26-33 <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/independent-oversight-institutions-and-regulatory-agencies-and-their> (Aksesuar për herë të fundit më 18 prill 2024)

40De Vrieze F. (2011), "Independent oversight institutions and regulatory agencies, and their relationship to parliament", WFD (Westminster Foundation for Democracy), London February 2019, faqe 27 <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/independent-oversight-institutions-and-regulatory-agencies-and-their> (Aksesuar për herë të fundit më 18 prill 2024)

Referuar të dhënave monitoruese ka institucione që nuk kanë përmbushur rekomandimet e Kuvendit apo titullarë që raportojnë për çfarë shohin ata të arsyeshme⁴¹. Raportimi anashkalon kërkesat ligjore dhe në veçanti udhëzimet e Kuvendit. Paraqitja e informacioneve shumë të detajuara për aktivitetet e zhvilluara humbet thelbin e problematikave të rëndësishme. Në këtë kontekst, është detyrë e Kuvendit që të realizojë një mbikëqyrje efikase për të rritur nivelin e duhur të llogaridhënies. Raporti i KQZ-së (praktikë pozitive) paraqitet konciz dhe shterues duke evidentuar problematikën e lindura si pasojë e mosveprimeve të aktorëve të tjerë. Gjithashtu KDIMDHP ka sqaruar në mënyrë shteruese përmbushjen e rekomandimeve të rezolutës duke i dedikuar një aneks të plotë për këtë qëllim.

1.3.3. ANALIZIMI DHE VLERËSIMI I RAPORTIT VJETOR NGA SHËRBIMI I MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE DHE RELATORI

Kuadri rregullator⁴² parashikon shqyrtimin paraprak të raportit vjetor nga relatori, përgjegjësia e të cilit konsiston në analizimin dhe vlerësimin e raportit të institucionit në monitorim në aspektin e pajtueshmërisë së tij me udhëzimet e parashikuara si dhe në aspektin substancial. Analiza duhet të fokusohet në performancën e institucionit në monitorim, plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi në rezolutën përkatëse, zbatimin e rekomandimeve të adresuara nga institucioni në monitorim për institucionet e tjera dhe zbatimin e rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë, nevojën për ndërhyrje legjislative, zbatimin e Kodit të Sjelljes si dhe në problematikën që ka hasur institucioni gjatë veprimtarisë së tij duke propozuar edhe zgjidhje adekuate.

Për të ushtruar një mbikëqyrje efikase përkrah relatorit/komisionit qëndron Shërbimi i Monitorimit në Kuvend, strukturë përgjegjëse për të ndihmuar Kuvendin dhe organet e tij në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës parlamentar mbi organet e pavarura kushtetuese dhe institucionet e tjera të pavarura të krijuara me ligj⁴³. Analizimi dhe vlerësimi i raportit vjetor të institucioneve në monitorim si në aspektin e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore ashtu edhe në aspektin substancial bëhet fillimisht nga ky shërbim⁴⁴.

41 P.sh. relatori në analizën që i ka bërë veprimtarisë së KLGJ-së ka konstatuar se nga 13 rekomandime që Kuvendi ka dhënë për këtë institucion në 2023 (gjithsej 13) 6 janë realizuar kënaqshëm dhe 7 pjesërisht. Në rastin e KMD-së rekomandimet e dhëna janë konsideruar nga relatori pothuajse të përcaktuara etj.

42 Shih: Manuali "Për monitorimin vjetor dhe periodik", pjesa e parë, I/1 në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20181227134148vendim%20nr.%20134%2C%20dt.%2020.12.2018.pdf> dhe Manualin për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen Parlamentare në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202312111950174946Manuali%20i%20Mbikëqyrjes%20dhe%20Kontrollit%20Parlamentar.pdf>

43 Shih Manualin e përshkrimit të punëve në Administratën e Kuvendit në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202401311153145219Manuali%20i%20p%C3%ABrshkrimeve%20t%C3%AB%20pun%C3%ABs%20%28janar%202024%29.pdf>

Kjo analizë i vihet në dispozicion relatorit, anëtarëve të komisionit përgjegjës parlamentar si dhe institucionit në monitorim⁴⁵.

Referuar procesverbaleve të komisioneve, por edhe monitorimit të drejtpërdrejtë të mbledhjeve rezulton se niveli i angazhimit të relatorit është i ndryshëm. Në disa raste relatori bën vetëm një përsëritje të asaj çfarë ka raportuar titullari i institucionit të pavarur⁴⁶, në disa raste, në analizën e tij, ndalet vetëm në shkallën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi në vitin e kaluar⁴⁷, në raste të tjera me analizë nënkuptohet dhënia e rekomandimeve për vitin në vijim⁴⁸ duke anashkaluar analizën për çështjet e tjera, të cilat referuar kuadrit rregullator janë të detyrueshme. Këto janë tregues të një mbikëqyrjeje sipërfaqësore dhe për pasojë joefektive. Nga ana tjetër referuar formatit të raportit të vlerësimit (Memo), që bën SHMI ngrihen pikëpyetje mbi përputhshmërinë e këtij raporti vlerësimi me fjalën e relatorit gjatë seancës dëgjimore.

1.3.4. ANGAZHIMI I DEPUTETËVE NË KOMISION

Referuar rregullave të procedurës shqyrtimi i raportit vjetor në komisionin parlamentar përgjegjës shoqërohet me pyetje-përgjigje dhe debat proces, i cili parashikohet të ezaurohet në një mbledhje të vetme. Nga monitorimi i kryer rezulton se numri i deputetëve që angazhohen në këtë proces mbikëqyrës paraqitet jo në nivel të kënaqshëm. Përgjithësisht, janë të njëjtët deputetë në çdo komision, që angazhohen në këtë proces, ndërkohë që komisionet kanë një anëtarësi të gjerë në numër. Mbikëqyrja ndaj këtyre institucioneve ushtrohet nga një grup i vogël deputetësh. P.sh. në shqyrtimin e raportit vjetor të KMD-së, ILDKPKI, KMSHC, KDIMDHP janë angazhuar përkatësisht 4 deputetë te dy institucionet e para dhe 2 deputetë te dy institucionet e dyta, ndërkohë që komisioni ka në përbërje 28 deputetë; në shqyrtimin e raportit vjetor të AMF janë angazhuar 5 deputetë, ndërkohë që ky komision ka në përbërje 21 deputetë; në shqyrtimin e raportit vjetor të ERRU janë angazhuar 4 deputetë, ndërkohë që ky komision përbëhet nga 25 deputetë etj.⁴⁹. Gjatë shqyrtimit të raportit vjetor të ASD-së fazat e shqyrtimit janë reduktuar vetëm në një prezantim tepër të shkurtër të tij nga titullari duke anashkaluar pyetjet dhe debatin parlamentar.

Seancat dëgjimore me titullarët e institucioneve të pavarura fillojnë në disa raste pa kuorum, në disa raste me kuorumin minimal dhe përfundojnë me 4 apo 5 deputetë në sallë. Mbledhja e komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të

44 Shih Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik, fq. 12. Formatit i raportit të vlerësimit të lëshuar nga SHMI dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

45Referuar fjalës së drejtuesit të mbledhjes së komisioneve përgjegjëse parlamentare.

46P.sh. në shqyrtimin e raportit vjetor të AMF-së, AIDSSH, ERRU, ISKPKSH....

47P.sh. në shqyrtimin e raportit vjetor të KMD, KMSHC, PP, ASD, KLGJ, KK, KPP, KLP....

48P.sh. në shqyrtimin e raportit vjetor të AMF-së

49 Në raportimin e KLSH-së angazhimi i deputetëve paraqitet shumë i lartë.

Drejtat e Njeriut në shqyrtimin e raportit vjetor të ILD-së, PP, ILDKPKI, AIDSSH, AP, mbledhja e komisionit për Ekonominë dhe Financat për shqyrtimin e raportit vjetor të AMF-së, KK-së apo mbledhja e komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në shqyrtimin e raportit vjetor të ISKPKSH janë ndër rastet.

Mungesa e theksuar e deputetëve në komision, jo vetëm sjell pavleshmërinë e mbledhjes, por dëshmon mungesë interesi të deputetëve për këtë proces. Që të jetë efikas, procesi mbikëqyrës kërkon angazhimin maksimal të të gjithë deputetëve ku barra e përgjegjësisë bie mbi relatorin. Sikurse ka theksuar edhe Unioni Ndërparlamentar “Deputetët duhet ta shohin kontrollin dhe mbikëqyrjen si një proces të rëndësishëm, në të cilin duhet të angazhohen. Nga ana tjetër partitë parlamentare duhet të lejojnë deputetët e tyre që të angazhohen në mënyrë konstruktive në të”⁵⁰. Nga ana tjetër edhe Komisioni i Venecias ka trajtuar rolin mbikëqyrës të parlamentit e veçanërisht punën e komisioneve duke theksuar se “komisionet e përhershme, duhet të ushtrojnë kontroll efikas në fushën e tyre të kompetencës, i cili nuk duhet të kufizohet në shqyrtimin e raporteve të paraqitura, por duhet gjithashtu të përfshijë një kontroll më aktiv të veprimeve të ekzekutivit dhe institucioneve të pavarura”⁵¹. Deputetët duhet të ndërgjegjësohen për benefitet që ka shoqëria si rrjedhojë e aktivitetit mbikëqyrës ndaj këtyre institucioneve. Një angazhim më i madh i tyre tregon prioritetin që i jep Kuvendi këtij procesi, por njëkohësisht rrit llogaridhënien dhe fuqizon transparencën.

1.3.5. TRAJTIMI I PROBLEMATIKAVE TË INSTITUCIONEVE NË MONITORIM

Megjithëse komisioni është përgjegjës në analizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së institucionit, në monitorim ai nuk luan rol aktiv në trajtimin e çështjeve apo problematikave të hasura nga institucioni gjatë veprimtarisë së tij. Në vijim, ISP sjell në vëmendje problematika të cilat njihen prej kohësh dhe kanë sjellë pengesa serioze në kryerjen e misionit kushtetues apo ligjor të këtyre institucioneve (si p.sh. aktet nënligjore apo bashkëpunimi ndërinstytucional që kërkojnë ndërhyrjen e Kuvendit) si dhe çështje të cilat kërkojnë vëmendjen e këtij institucioni për të ushtruar mbikëqyrjen në mënyrë efikase dhe të plotë (si p.sh. kodi i etikës apo transparenca institucionale).

Mungesa e akteve nënligjore është një problematikë e vjetër, që pengon institucionet në monitorim për të ushtruar funksionet në mënyrë efikase. Është përgjegjësi e Kuvendit që të sigurohet se legjislacioni sekondar është miratuar brenda afateve të përcaktuara prej tij dhe në përputhje me legjislacionin primar.

⁵⁰Unioni Parlamentar Ndërkombëtar (2017) <https://www.ipu.org/work-with-ipu/vacancies/2020-11/lead-author-global-parliamentary-report> (Aksesuar për herë të fundit më 28.4.2024)

⁵¹Opinion nr. 845/2016 të Komisionit të Venecias, “Parametrat në Marrëdhënien në mes të shumicës parlamentare dhe opozitës në demokraci”, CDL-AD (2019) 015 i 24 qershorit 2019, paragrafi 92.

Ky institucion duhet të krijojë domosdoshmërisht një mekanizëm për të monitoruar nxjerrjen dhe përmbushjen e akteve nënligjore⁵². Të dhënat monitoruese tregojnë se aktet nënligjore (detyrim ligjor për KM) në zbatim të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" të ndryshuar⁵³ mungojnë që prej 9 vitesh; aktet nënligjore (për të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare) në lidhje me vetidentifikimin e lirë dhe përdorimin e gjuhëve në zbatim të ligjit nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH" (detyrim ligjor për KM) mungojnë prej kohësh, shqetësim ky i ngritur edhe në progres raportin e KE-së për Shqipërinë (2023)⁵³; akti nënligjor në zbatim të ligjit 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" të ndryshuar⁵⁴ (për personat e zhdukur që nga koha e komunizmit) (detyrim ligjor për KM) mungojnë prej 4 vitesh etj.

Mosmiratimi i akteve nënligjore plotësisht apo edhe pjesërisht i bën disa segmente të ligjit joefektivë dhe të pazbatueshëm duke ndikuar në veprimtarinë e institucionit (KMD, AIDSSH).

Çështja e rekrutimit të inspektorëve magjistratë pranë ILD-së, nga KLP dhe KLGJ, mbetet shqetësim i mbartur ndër vite dhe që nuk ka gjetur zgjidhje.

- ILD që prej krijimit si institucion e ka ngritur disa herë këtë problem të krijuar kryesisht për shkak të kriterëve ligjore, por edhe për arsye të tjera objektive me të cilat është përballur sistemi. Rekrutimi i inspektorëve dhe përmirësimi i kapacitetit të ILD-së është shqetësim i ngritur edhe nga KE⁵⁴.
- Mungesa e inspektorëve magjistratë, është faktor me ndikim të lartë në ushtrimin e funksioneve të këtij institucioni. ILD ka kërkuar ndërhyrje ligjore nga Kuvendi për të zgjidhur situatën e krijuar, por deri më sot nuk ka asnjë hap konkret në këtë drejtim. Kuvendi, me kërkesë të ILD-së, ka bërë ndryshime në strukturën dhe organikën e këtij institucioni me pakësimin e numrit të inspektorëve nga 26 inspektorë në 20 inspektorë dhe shtimin e numrit të ndihmës inspektorëve nga 7 në 23, por kjo nuk e zgjidh përfundimisht problemin në fjalë⁵⁵.

52 Shënim: ISP ka rekomanduar krijimin e një sistemi on-line software, i cili të mundësojë aksesin në kohë reale dhe komunikimin ndërinstitutional midis Kuvendit dhe institucioneve që kanë detyrimin për t'i nxjerrë ato.

53Shih Raporti KE për shqyrtimin analitik (Screening) për grup - kapitujt 1, (Themelorët) fq. 31 dhe 42 në linkun <https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404041324018899Albania%20report%202023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 05.05.2024)

54 Po aty, fq. 24

55Shih vendimin e Kuvendit nr. 10/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 28/2020 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë"⁵⁵ në linkun <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/28/37a566f8-4da6-476c-9f48-463d724a6576> fq. 2623

- Në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës përmendet plotësimi gradualisht i pozicioneve të inspektorëve magjistratë deri në vitin 2026⁵⁶, ndërsa Kuvendi në rezolutën 2024 për vlerësimin e veprimtarisë së ILD-së ka dhënë rekomandimin “T’i kushtohet vëmendje e veçantë plotësimit të vakancave në pozicionet e inspektorit magjistrat dhe të inspektorit jomagjistrat”, duke e lënë problemin përsëri të pazgjidhur.

Mungesa e reagimit institucional ndaj kërkesave/rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit është një tjetër problematikë e vjetër. P.sh. megjithëse AP ka përcaktuar një tërësi veprimesh me qëllim forcimin e bashkëpunimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, ky i fundit nuk i është përgjigjur AP-së në lidhje me moszbatimin e një rekomandimi si dhe për disa çështje të tjera, që lidhen me procedurat e legalizimit. Në këtë kontekst, është shumë i rëndësishëm forcimi i mëtejshëm i rolit mbikëqyrës të Kuvendit për të mundësuar zbatimin e rekomandimeve që ky institucion u ka drejtuar ekzekutivit dhe institucioneve të tjera publike.

Çështjet me ndjeshmëri të lartë publike, për të cilat janë dhënë rekomandime nga AP, kërkojnë mbledhjen në një tryezë të përbashkët të AP-së, titullarit të institucionit shtetëror përgjegjës, që nuk ka zbatuar rekomandimet si dhe të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin si një instrument efektiv për të adresuar problematika konkrete. Gjithashtu, AP ka dërguar pranë Kuvendit një sërë raportesh të veçanta (për çështje të ndryshme brenda funksioneve të tij), të cilat ngrenë problematika dhe shqetësime në fusha të caktuara, por që këto raporte rezultojnë të mos jenë diskutuar as në komisionin përgjegjës parlamentar, as në seancë plenare duke mos i dhënë mundësinë këtij institucioni të adresimit të drejtpërdrejtë të këtyre problematikave apo shqetësimeve si dhe për të diskutuar me institucionet publike, të cilat kanë detyrimin për t’i adresuar ato.

Referuar Manualit për monitorimin vjetor dhe periodik institucionet e pavarura kanë detyrimin për të miratuar Kodin e Etikës. Një kornizë etike, rrit llogaridhënien dhe mbron institucionin nga ndërhyrjet e panevojshme politike duke kontribuar edhe në pavarësinë⁵⁷.

Rezultojnë se institucionet nuk kanë raportuar për zbatimin e Kodit të Sjelljes, por edhe se nga Kuvendi nuk është bërë ndonjë vlerësim për zbatimin e tij nga organet drejtuese të këtyre institucioneve (në veçanti Bordet). Organizmat ndërkombëtarë si KE, GRECO i kanë kushtuar përherë vëmendje të veçantë hartimit dhe zbatimit të duhur

⁵⁶Shih Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës në linkun <https://www.drejtesia.gov.al/baza-ligjore-dokumente/> fq. 8 (Aksesuar për herë të fundit më 24.05.2024)

⁵⁷Shih De Vrieze F. (2011) në “Independent oversight institutions and regulatory agencies, and their relationship to parliament”, WFD (Westminster Foundation for Democracy), London February 2019, faqe 33 aksesuar për herë të fundit më 18.05.2024 <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/independent-oversight-institutions-and-regulatory-agencies-and-their>

të kornizës etike për funksionarët e lartë të shtetit si faktorë ndikues në parandalimin e korrupsionit si dhe në pavarësinë, llogaridhënien dhe integritetin institucional.

Etika dhe transparenca konsiderohen ndër instrumentet e llogaridhënies. Transparenca rrit besimin e publikut tek institucioni dhe promovon kulturën e llogaridhënies. Të dhënat monitoruese tregojnë se faqet e internetit të institucioneve të pavarura nuk përmbushin standardin e duhur. Një sërë dokumentesh, të cilat përfshihen në të ashtuquajturin Programi i Transparencës mungojnë duke vështirësuar marrjen e informacionit nga publiku. Të vetmet institucione që janë përmendur për mungesë të dhënash në faqet e tyre janë ISKPKSH, KDRTSH dhe KLGJ, ndërkohë që një sërë institucionesh të tjera nuk e zbatojnë Programin e Transparencës konform rregullave.

1.3.6. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE/ PLATFORMA NDËRINSTITUCIONALE

Aspekt tjetër dhe që kërkon vëmendje nga ana e komisionit përgjegjës, në këtë proces, është edhe zbatimi i rezolutave të Kuvendit si dhe i rekomandimeve që AP, KLSH, AK, KMSHC, KMD dhe KDIMDHP adresojnë kundrejt organeve të ekzekutivit dhe njësive të varësisë. Raportimi nga titullari i institucionit të pavarur lidhur me nivelin e zbatimit të tyre përbën një ndër kërkesat ligjore për raportim, ndërkohë që vlerësimi i nivelit të zbatimit të tyre mbetet përgjegjësi e relatorit. Rezulton se relatori fokusohet vetëm në zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit dhe anashkalon zbatimin e rekomandimeve të 6 institucioneve të pavarura. Nga ana tjetër edhe ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për raportim lidhur me statusin e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

Monitorimi për ecurinë dhe implementimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura drejtuar ekzekutivit dhe njësive të varësisë bëhet nëpërmjet platformës ndërinstitucionale (online), por rezulton se platforma vijon të mos ketë mekanizma përcjellës për t'u siguruar se rekomandimet janë duke u zbatuar. Procesi i ndjekjes dhe vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve është një proces që duhet ndjekur me korrektësi, të dokumentohet me kujdes dhe të vlerësohet me profesionalizëm. Vetë platforma ndërinstitucionale duhet të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që të gjenerojë informacione statistikore për të qenë të besueshme. Mbetet ende i nevojshëm përmirësimi i mëtejshëm i punës për zbatimin e rekomandimeve me një ndjekje më dinamike të zbatimit të tyre për të rritur shkallën e zbatueshmërisë së tyre.

1.3.7. RAPORTI I KOMISIONIT PËR PROCESIN RAPORTUES TË INSTITUCIONIT NË MONITORIM

Referuar kuadrit rregullator⁵⁸ komisioni përgjegjës në përfundim të shqyrtimit të raportit vjetor harton raportin që i paraqitet seancës plenare dhe në të cilin duhet të referojë (pa u kufizuar) çështjet e mëposhtme:

- Sqarim të përgjithshëm të përmbledhur të seancave, çështjeve të trajtuara dhe problematikave kryesore;
- Vlerësimin e zbatimit të rezolutës së vitit të kaluar;
- Vlerësimin e performancës së institucionit;
- Vlerësimin e zbatimit të Kodit Etik dhe të Sjelljes nga zyrtarët e emëruar nga Kuvendi;
- Mënyrën e votimit dhe qëndrimin e pakicës nëse ka.

Ndonëse çështjet që duhet të trajtojë komisioni në raport janë të mirëpërcaktuara, në to mungon informacioni lidhur me problematikat e hasura dhe zgjidhjen e tyre, zbatimin e rezolutës së vitit të kaluar, performancën e institucionit (arritjet/mangësitë) apo zbatimin e Kodit Etik nga organi drejtues i institucionit. Qëndrimi i pakicës nuk reflektohet në asnjë rast, megjithëse projektrezolutat në komisione referuar raporteve rezultojnë të jenë miratuar me shumicë votash. Gjithashtu nuk identifikohen deputetët që kanë votuar pro, kundër apo abstenim. Raporti është produkt i punës së komisionit dhe si i tillë reflekton cilësinë e mbikëqyrjes. Problematika shfaqet e njëjtë me vitin e kaluar për të cilën ISP sugjeroi përmbushjen e kërkesave ligjore dhe referimin e çështjeve të parashikuara në këto raporte.

⁵⁸Manuali "Për monitorimin vjetor dhe periodik", formati i raportit të komisionit parlamentar për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit në monitorim bashkëlidhur manualit.

2. SHQYRTIMI NË SEANCË PLENARE

2.1. ANGAZHIMI I DEPUTETËVE NË VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT NË MONITORIM

Seanca plenare është forumi në të cilin raportet vjetore të këtyre institucioneve marrin vëmendjen e publikut dhe vendosin përpara përgjegjësisë si titullarin e institucionit, ashtu edhe Qeverinë për zgjidhjen e çështjeve të adresuara.

Numri i deputetëve që angazhohen vijon të jetë i ulët edhe në seancë plenare çka tregon mosinteresim të deputetëve për të ushtruar kontroll. Debati i zhvilluar për të vlerësuar veprimtarinë e këtyre institucioneve ka qenë në pak raste racional, konstruktiv dhe argumentues, në raste të tjera ka pasur diskutime për çështje që nuk lidhen me natyrën e raportimit. Kjo fazë shqyrtimi vijon të karakterizohet nga një mungesë e theksuar e deputetëve në sallën e seancave, indikator i mungesës së përgjegjësisë dhe seriozitetit për të ushtruar mbikëqyrje. Në rastin e raportimit të ERRU-t shqyrtimi është reduktuar vetëm në votimin e projektrezolutës duke anashkaluar të gjitha fazat e tjera, të cilat referuar kuadrit rregullator janë detyruese⁵⁹. Ajo që ngre pikëpyetje mbi cilësinë e mbikëqyrjes parlamentare është edhe përfshirja në të njëjtën seancë plenare e disa institucioneve për raportim.⁶⁰

3. MIRATIMI I REZOLUTËS PËR INSTITUCIONIN E PAVARUR NË MONITORIM

Kuvendi e vlerëson veprimtarinë e institucioneve në monitorim nëpërmjet rezolutës së propozuar nga relatori dhe miratuar nga komisioni përgjegjës parlamentar. Referuar kuadrit rregullator në rezolutë duhet të gjejnë parashikim çështjet kryesore të dala nga vlerësimi i veprimtarisë, vlerësimi i performancës së institucionit si dhe rekomandimet e Kuvendit për t'u zbatuar ose plotësuar gjatë vitit në vazhdim. Në praktikë, rekomandimet e pazbatuara apo të plotësuara pjesërisht bëhen pjesë e rezolutës. Megjithatë, rezolutat përmendin vetëm drejtimit ku institucionet e pavarura, vlerësohen pozitivisht për veprimtarinë e tyre dhe nuk përmendin drejtimit ku institucioni ka dështuar apo nuk ka pasur efikasitet ose përmirësime të dukshme.

⁵⁹Shih procesverbalin e seancës plenare datë 06.06.2023 në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202406131212225504Procesverbal%20dat%C3%AB%206.6.2024.pdf>

⁶⁰Shih seancat plenare 15.07.2024, 18.07.2024, 25.07.2024 në të cilat kanë raportuar nga 5 institucione.

4. KONKLUZION

Kuvendi gjatë vitit 2024, në ushtrim të funksionit mbikëqyrës, ka përmbushur detyrimin kushtetues dhe ligjor për mbikëqyrje ndaj institucioneve të pavarura. 26 institucione kushtetuese dhe të krijuara me ligj kanë raportuar në Kuvend gjatë periudhës prill-korrik lidhur me veprimtarinë e tyre vjetore pararendëse dhe shkallën e përmbushjes së objektivave të ngarkuara nga ligji. Disa prej problematikave të ndeshura janë të ngjashme me ato të vitit 2023 dhe kanë të bëjnë kryesisht me depozitimin në Kuvend të raporteve vjetore përtej afatit ligjor, mosrespektimin e kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Kuvendit për strukturën dhe përmbajtjen e raportit vjetor, nevojën për një analizë dhe vlerësim më të thelluar të raporteve vjetore nga Kuvendi, mungesën e deputetëve në seancat mbikëqyrëse dhe të adresimit të çështjeve që lidhen me funksionimin e tyre si dhe me nevojën për monitorim më efikas të ecurisë dhe implementimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura drejtuar ekzekutivit dhe njësisë të varësisë.

Përdorimi i kufizuar i mekanizmave për mbikëqyrje ndaj këtyre institucioneve vijon të jetë shqetësimi kryesor. Raportimi është i vetmi instrument, që shfrytëzon Kuvendi për të kontrolluar punën e institucioneve të pavarura, ndonëse kuadri ligjor parashikon një sërë mekanizmesh, të cilat mund të shfrytëzohen veçanërisht për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve. Përdorimi i kufizuar i instrumenteve kushtetuese dhe ligjore të mbikëqyrjes parlamentare ndaj institucioneve të pavarura është një shqetësim i ngritur edhe në progresraportin e KE-së për shqyrtimin analitik (Screening)⁶¹. Që procesi mbikëqyrës të jetë efektiv, këto institucione duhet të mbahen nën mbikëqyrje në mënyrë të vazhdueshme dhe duke shfrytëzuar të gjithë mekanizmat e parashikuara. Nevoja për një komunikim të vazhdueshëm midis këtyre dy aktorëve është parë si e domosdoshme edhe nga vetë këto institucione⁶². Rezulton se mbikëqyrja parlamentare realizohet nga një përqindje e ulët e deputetëve. Që ky proces të jetë efikas kërkohet një përfshirje më e gjerë. Mbetet shqetësuese mungesa e deputetëve në komisione apo seancë plenare gjatë seancave mbikëqyrëse, gjë që tregon mungesë interesi për këtë proces.

61 Shih progres raportin e KE për Shqipërinë për vitin 2024 në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404041324018899Albania%20report%202023.pdf> "Mbikëqyrja e parlamentit mbi punën e institucioneve të pavarura vazhdon të kufizohet vetëm në shqyrtimin e raporteve të tyre vjetore dhe një programi kompjuterik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga këto institucione".

62 Shih: Mbledhja e komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut datë 23.05.2024, fjala e ILD-së.

Element që shënon progres (krahasuar me procesin e vitit 2023) është përfshirja e raporteve vjetore në platformën e konsultimit publik, por edhe në këtë drejtim mbetet e nevojshme që kjo përfshirje të mos trajtohet si çështje formale.

Mbetet e paqartë se cilat OSHC kanë analizuar performancën e institucioneve të pavarura, komentet apo rekomandimet që kanë paraqitur në platformën e konsultimit publik, nëse këto komente kanë gjetur trajtim gjatë mbikëqyrjes në komision dhe nëse kanë gjetur reflektim në rezolutën drejtuar institucioni. Kuvendi duhet të garantojë angazhim të vërtetë, kuptimplotë dhe joformal të OSHC-ve në këtë proces.

5. REKOMANDIME

Si institucioni kryesor në jetën politike të vendit, por edhe në procesin e integritetit drejt Bashkimit Evropian (BE), Kuvendi, e ka të domosdoshëm fuqizimin e mëtejshëm të ushtrimit të funksioneve kushtetuese që t'i mundësojnë përballjen me sfidat e hyrjes në këtë organizëm ndërkombëtar. Në këtë kontekst, duke parë problematikat e hasura gjatë procesit mbikëqyrës dhe duke u qëndruar rekomandimeve të dhëna në 2023, ISP vlerëson se Kuvendi duhet të punojë fort për të fuqizuar këtë proces si dhe për të pasur qasje pozitive ndaj praktikave dhe kërkesave të BE-së, që të mund të dëshmojë se është gati për t'u anëtarësuar në familjen e madhe evropiane.

Zhvillimi i procesit mbikëqyrës parlamentar në pajtim të plotë me standardet evropiane është faktor i rëndësishëm drejt BE-së pasi dëshmon nivel të lartë transparence, llogaridhënieje dhe përgjegjësie nga Kuvendi, tregues këto të një parlamenti demokratik dhe që shërbejnë si barometër për t'u anëtarësuar në këtë organizëm ndërkombëtar.

- Në këtë kontekst, është përgjegjësi e Kuvendit që këtë proces ta zhvillojë duke shfrytëzuar me efektivitet të gjithë mekanizmat kushtetues dhe ligjorë, në mënyrë sistematike, të qartë dhe rigoroze për të mos mbetur tek komunikimi me bazë vjetore apo në disa raste edhe katër mujore. Nevojitet vullnet për shfrytëzimin me efektivitet të të gjitha mekanizmave të parashikuar në mënyrë që procesi të kryhet i plotë. Fuqizimi i funksionit mbikëqyrës përmes mekanizmave adekuatë dhe praktikave evropiane, do të kontribuojë në rritjen e nivelit të përgjegjësisë nga ana e pushtetit ekzekutiv dhe institucioneve të pavarura.
- Kuvendi duhet të forcojë rolin e tij mbikëqyrës mbi punën e institucioneve të pavarura, duke përfshirë edhe sigurimin e monitorimit sistematik të rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe ndjekjen e tyre⁶³.

63Shih Raporti KE për shqyrtimin analitik (Screening) për grup - kapitujt 1, (Themelorët) në linkun <https://ku>

Kërkohet ekspertizë e mëtejshme në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve sikurse parashikohet edhe në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës⁶⁴.

- Kuvendi duhet të përmirësojë mekanizmat dhe praktikën e mbikëqyrjes parlamentare si dhe të zbatojë në mënyrë efektive mekanizmin ndërinstitucional Kuvend - institucione të pavarura - ekzekutiv me qëllim rritjen e cilësisë së mbikëqyrjes parlamentare⁶⁵. Shfrytëzimi me efektivitet i mekanizmave specifike për llogaridhënie, transparencë dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve rrit besimin dhe sigurinë e publikut jo vetëm tek Kuvendi, por edhe tek këto institucione. Pa shfrytëzimin e të gjitha mjeteve kushtetuese dhe ligjore të parashikuara, mbikëqyrja e legjislativit do të jetë përherë e pjesshme dhe e pamjaftueshme.

vendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404041324018899Albania%20report%202023.pdf (Aksesuar për herë të fundit më 05.05.2024)

⁶⁴Shih Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës në linkun <https://www.drejtësia.gov.al/baza-ligjore-dokumente/> fq. 24 (Aksesuar për herë të fundit më 24.05.2024)

“Parlamenti nxit aktivitetet e tij mbikëqyrëse me qëllimin për të siguruar një zbatim më të mirë të rekomandimit të Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave deri në vitin 2026”.

⁶⁵ Plani strategjik i Kuvendit 2020-2025 miratuar me vendimin nr. 56/2021 të Kuvendit. <https://web-api.parlament.al/Files/20211025114206vendimi%20dhe%20plani%20strategjik.pdf> Aksesuar për herë të fundit më 3.4.2024

MBIKËQYRJA PARLAMENTARE
DHE FUNKSIONI ZGJEDHOR
2024

PJESA E DYTË:
ZGJEDHJA/EMËRIMI NË ORGANET KUSHTETUESE
OSE TË KRIJUARA ME LIGJ
NGA KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

HYRJE

Kushtetuta dhe ligje të posaçme i atribuojnë Kuvendit edhe funksionin zgjedhës/shkarkues, funksion që nënkupton zgjedhjen, emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Këto institucione janë me rëndësi kyçe në sistemet demokratike të qeverisjes dhe ky status kërkon vendosjen e standardeve të larta të profesionalizmit dhe integritetit. Arritja e këtyre standardeve kërkon domosdoshmërisht ushtrimin me efikasitet të këtij funksioni nga të gjitha organet e përfshira në këtë proces.

Zgjedhja e funksionarëve të lartë të shtetit është rezultat i një procesi kompleks ndërveprimi dhe bashkëpunimi mes aktorëve të ndryshëm pjesëmarrës, efikasiteti i të cilit lidhet me organizimin e këtij procesi dhe shkallën e bashkëpunimit mes aktorëve. Që të jetë efikas dhe i plotë, procesi kërkon angazhim maksimal nga të gjithë aktorët pjesëmarrës për të përmbushur, sipas rolit dhe kompetencave, një sërë detyrimesh të parashikuara në kuadrin rregullator dispozitat e të cilit përfshijnë elementët e mëposhtëm:

- respektimin e afateve kohore në çdo fazë të procesit në mënyrë që të shmangen vonesat në plotësimin e vakancës, të mos krijohet bllokim institucional dhe të garantohet një vazhdimësi në veprimtarinë e përditshme të institucionit përkatës⁶⁶;
- bashkëpunimin në kohë me institucione të tjera për marrjen e informacioneve të nevojshme mbi aspekte të rëndësishme të figurës së kandidatit⁶⁷;

⁶⁶Afat kohor për: (1) shpalljen e vendit vakant nga organi propozues, (2) paraqitjen në Kuvend të kandidaturave, (3) shqyrtimin e kandidaturës në komisionin përgjegjës dhe (4) shqyrtimin në seancë plenare.

⁶⁷Kuvendi, mbështetur në ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i kërkon të dhëna Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit

- zhvillimin efektiv të seancave dëgjimore me kandidatët për të krijuar mundësi njohjeje sa më të plotë dhe të thellë të kandidaturave;
- përfshirjen e shoqërisë civile si në fazën paraprake të përzgjedhjes së kandidaturave ashtu edhe në seancat dëgjimore, që zhvillon komisioni përgjegjës me kandidatët me qëllim shmangien e ndikimit politik; si dhe
- angazhimin maksimal të deputetëve në komisionin parlamentar përgjegjës dhe seancë plenare.

Instituti i Studimeve Politike, në kuadër të projektit “Rritja e llogaridhënies së qeverisë përmes një parlamenti më reagues” i cili po realizohet nga Fondacioni Westminster për Demokracinë (WDF) me mbështetjen financiare nga Ambasada Britanike në Tiranë, nga analiza e bërë në punimin e vitit 2023 lidhur me zgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e titullarëve dhe anëtarëve të organeve drejtuese të këtyre institucioneve, evidentoi një sërë problematikash të lidhura ngushtë si me zhvillimin e procesit në organin propozues, konkretisht, vonesat në iniciimin e procesit, mospërfshirjen e shoqërisë civile në procesin paraprak të përzgjedhjes së kandidaturave dhe paraqitjen në Kuvend përtej afatit të përcaktuar me ligj, ashtu edhe me zhvillimin e procesit në organin e emërtesës, Kuvendin e RSH-së, konkretisht, mospublikimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidaturat (CV dhe dokumentacioni shoqërues), mospërfshirjen e shoqërisë civile në seancat dëgjimore me kandidatët, nivelin e ulët të angazhimit të deputetëve në seancat dëgjimore me kandidaturat, mungesën e standardizimit të formatit të raportit të komisionit parlamentar përgjegjës si dhe shqyrtimin në seancë plenare përtej afatit të përcaktuar me Rregullore Kuvendi dhe pa debat parlamentar.

Në vijim të problematikave ISP paraqiti rekomandimet përkatëse, të cilat synonin plotësimin në kohë të vendeve vakante në organet kushtetuese apo të krijuara me ligj, minimizimin e ndikimit politik dhe formimin me anëtarë cilësorë e figura të spikatura me integritet të lartë profesional dhe etiko-moral, si dhe ruajtjen dhe forcimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së institucioneve të pavarura me kandidatë të tillë, që është thelbësore për misionin kushtetues dhe ligjor, që ato kryejnë. ISP po vazhdon të monitorojë procesin zgjedhës/emërues dhe në kuadër të projektit ka realizuar raportin monitorues për procesin zgjedhor 2024.

Qëllimi i këtij raporti është të shërbejë si mjet i pavarur për vlerësimin e procesit zgjedhës në Kuvend duke u fokusuar në identifikimin e përmirësimeve të mundshme si rezultat i rekomandimeve të dhëna vitin paraardhës (raporti 2023) si dhe dhënien e rekomandimeve të tjera se çfarë mund të përmirësohet në drejtim të këtij procesi. Raporti, nën dritën e një këndvështrimi krahasues, analizon të gjitha fazat e procesit për të evidentuar problematikat dhe gjetjet pozitive në secilën prej tyre.

për kandidatët e propozuar si dhe Prokurorit të Përgjithshëm (PP) në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për verifikimin e të dhënave të deklaruara nga kandidati në formularin e dekriminalizimit.

1. PROCESI PARAPRAK NË INSTITUCIONIN PROPOZUES

1.1. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE PËR SHPALLJEN E VENDIT VAKANT

Realizimi i procesit zgjedhës/emërues në mënyrë efektive kërkon domosdoshmërisht respektimin e kërkesave të parashikuara në Kushtetutë, ligje organike dhe Rregulloren e Kuvendit. Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë merr respektimi i afateve ligjore, si një ndër kërkesat që kushtëzojnë të gjithë procedurën e efikasitetit të procesit. Me qëllim që procesi të kryhet në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, është i domosdoshëm respektimi rigoroz i rregullave ligjore në lidhje me periudhën kohore për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara procedurale. Një ndër afatet ligjore në këtë proces është edhe afati kohor për shpalljen e vendit vakant.

Procesi zgjedhës, i cili fillon në organin propozues dhe mbaron në Kuvend⁶⁸, starton pikërisht me shpalljen e vendit vakant nga institucioni propozues. Njoftimi dhe shpallja e vendit vakant shënon zyrtarisht nisjen e procesit për plotësimin e vakancave në institucionin e pavarur, pas së cilës të interesuarit për të kandiduar dhe që plotësojnë kushtet e parashikuara në legjislacionin përkatës, brenda një afati kohor, shprehin interesin e tyre përmes një kërkesë me shkrim drejtuar organit propozues⁶⁹. Ky është një moment delikat dhe që kërkon përgjegjësi nga institucioni propozues, por në të njëjtën kohë edhe vëmendje nga institucioni i emërtesës (Kuvendi) pasi mosrespektimi i tij në këtë fazë rrezikon të dëmtojë procesin duke u bërë shkas për mosplotësimin në kohë të vendeve vakante. Kjo fazë e procesit ka pasur hapësirën e saj në media⁷⁰, por edhe shoqëria civile në mënyrë të vazhdueshme ka nënvizuar rëndësinë e saj.

Ligjet organike (përgjithësisht) parashikojnë afate kohore për nisjen e procedurës nga subjekti propozues, megjithatë rezulton se kuadri ligjor për sa i përket çështjes së afatit për nisjen e procedurës në zgjedhjen e titullarëve apo anëtarëve të organeve drejtuese të tyre nuk parashikon një model unik.

⁶⁸Në rastet kur Kuvendi është edhe organ propozues edhe organ zgjedhës procedura fillon dhe mbaron në këtë institucion (Kuvend).

⁶⁹Shpallja e konkurimit për vendin e lirë përmban të dhëna si: Një përshkrim të shkurtër të natyrës së punës dhe funksionit që do të mbulojë; listën e kriterëve të pranimit; listën e dokumenteve që duhet të paraqiten; vendin ku duhet të paraqiten dhe afatin deri kur do të paraqiten dokumentet (përgjithësisht afati është 20 ditë; datën kur do të shpallet lista e kandidatëve, që do të kualifikohen për fazën e testimit; datën dhe vendin e zhvillimit të testimit; mënyrën e njoftimit e të komunikimit me palët; fushat e njohurive, për të cilat do të intervistohen kandidatët dhe bibliografitë përkatëse.

⁷⁰ Shih: https://ata.gov.al/2022/10/05/kuvendi-shpall-vendin-vakant-per-anetar-bordi-te-ere-s/?doing_wp_cron=1713722458.9480659961700439453125 (Aksesuar për herë të fundit më 20.04.2024) <https://www.oranews.tv/article/hapet-gara-per-anetar-te-keshillit-te-statistikave> <https://www.monitor.al/kryeministria-shpall-kandidaturat-per-anetaret-e-komisionit-te-konkurrences/> <http://www.panorama.com.al/shpallje-e-vendeve-vakante-dhe-thirrje-per-paraqitjen-e-shprehjes-se-interesit-per-anetare-te-keshillit-te-larte-gjyqesor-si-dhe-anetare-te-keshillit-te-larte-te-prokurorise-nga-radhet-e-avokat-eve/>

Ligje të ndryshme organike parashikojnë afate të ndryshme për nisjen e procesit⁷¹. Ka ligje që nuk parashikojnë një afat të tillë. Nga ana tjetër, edhe në rastet kur nisja e procedurës përcaktohet në ligj, ky i fundit nuk parashikon penalitete për organin propozues në rastet kur ky afat nuk respektohet. Në këtë aspekt, rekomandimi për ndërhyrje legjislative në ligjet përkatëse organike për përcaktimin e afatit apo parashikimin e masave ndëshkuese ka qenë një ndër rekomandimet e dhëna, por që nuk ka gjetur reflektim.

Mosrespektimi i afatit ligjor në shpalljen e vendit vakant është identifikuar edhe gjatë procesit zgjedhës/emërues 2024. Nga monitorimi rezulton se Kuvendi ka bërë njoftimin për shpalljen e vendit vakant për kryetar dhe anëtar të ERRE-s 72 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit në detyrë megjithëse, sipas ligjit organik, institucioni propozues, në këtë rast Ekipi Përzgjedhës⁷², duhet të fillonte procedurën jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të mandatit të kryetarit apo njërit prej anëtarëve të bordit me publikimin e njoftimit për vendin vakant⁷³.

- Rezulton se shpallja e vendeve vakante është bërë nga Kuvendi më 15.12.2023⁷⁴, ndërkohë që kryetarit dhe anëtarit në detyrë i mbaronte mandati më 26.02.2024. Ekipi Përzgjedhës si organ propozues, duhet ta kishte nisur më herët procedurën paraprake të përzgjedhjes me qëllim plotësimin e vendit vakant përpara mbarimit të mandatit të kryetarit dhe anëtarit në detyrë pavarësisht se Kuvendi si organ i emërtesës ka arritur (në këtë rast) ta finalizojë procesin e zgjedhjes së kandidaturës brenda afatit të përcaktuar me Rregullore (jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i mandatit)⁷⁵.
- Vonesa të pajustificuara në shpalljen e vendit vakant janë konstatuar edhe në rastin e dy anëtarëve të Bordit të AMF-së që mbajnë funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv dhe kryetarit të Bordit, propozime respektivisht të Ministrisë së

71 P.sh. 3 muaj para mbarimit të mandatit të anëtarit në detyrë për: KK, AMF, AP, ERRE, 6 muaj për KPP, 30 ditë për kryetarin e KDRTSH etj. Për anëtarët e KDRTSH 30 ditë pas krijimit të vendit vakant. ISP ka rekomanduar hartimin e një ligji kuadër për institucionet e pavarura, i cili ndër të tjera të parashikojë një model unik në drejtim të këtij afati.

72 Shpallja e vendit vakant bëhet nga Kuvendi për shkak të përbërjes së Ekipit Përzgjedhës. Ekipi Përzgjedhës i bordit përbëhet nga dy përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, përkatësisht, kryetari i komisionit përgjegjës për energjinë dhe kryetari i komisionit përgjegjës për ekonominë dhe nga ministri përgjegjës për energjinë. Ekipi Përzgjedhës përzgjedh paraprakisht dy kandidatë që plotësojnë kërkesat ligjore dhe ia propozon Kuvendit.

73 Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar⁷⁴, neni 11, pika 4.

74 Shih: <https://www.parlament.al/lajme/ae31c1b1-f84d-4b0e-9a0c-66a278aae1ad> (Aksesuar për herë të fundit më 21.04.2024)

75 Neni 111/7

Financave⁷⁶ dhe Kuvendit (KEF)⁷⁷. Rezulton se shpallja për këto funksione është bërë më 14.05.2024 (për vendin e parë vakant) megjithëse nuk ka një vendim Kuvendi (sipas përcaktimit në ligjin organik⁷⁸) për lirimin nga detyra të anëtarit që mbante më parë këtë funksion dhe më 22.07.2024 (për vendin e dytë vakant).

Ndërsa në rastin e propozimit të anëtarit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë (KMBSH) apo shpalljes së vendeve vakante për anëtarë të Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri (ISKPKSH) nga Rektorati dhe Akademia e Shkencave nuk ka asnjë informacion në faqen e këtyre institucioneve në internet lidhur me inicimin e procesit për të konkluduar nëse është respektuar ose jo afati ligjor. Për këto raste ngrihen dyshime të forta se procesi në institucionet propozuese përkatëse ka qenë i mbyllur (jo transparent) dhe pa garë⁷⁹.

Procesi në fazën e propozimit, duhet të jetë i hapur dhe publik dhe të bazohet në parimin e transparencës, shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës e profesionalizmit. Është përgjegjësi e organeve propozuese që të miratojnë rregulla të hollësishme për zhvillimin e procedurës paraprake të përzgjedhjes së kandidaturave.

Përvojë pozitive afirmohet në shpalljen e vendit vakant për anëtar të Bordit të AMF-së që mban funksionin e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv. Referuar të dhënave rezulton se vendi vakant është krijuar në shtator 2023, ndërkohë që në faqen e Kryeministrisë (organ propozues: KM) rezultojnë një shpallje dhe një rishpallje përkatësisht në datat 20.09.2023⁸⁰ dhe 06.10.2023⁸¹.

76 Shih shpalljen në linkun <https://financa.gov.al/newsroom/njofitime/> (Aksesuar për herë të fundit më 14.05.2024). Vendi vakant është krijuar më 11.04.2024 me zgjedhjen e nëndrejtorit ekzekutiv në funksionin e drejtorit ekzekutiv të Bordit. Shih vendimin e Kuvendit në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404121001352029Flet%C3%AB%20votimi.pdf>
77 Shih shpalljen në linkun <https://www.parlament.al/lajme/ab28ded0-8eed-46cc-b9e2-ceec5641b0c2> (Aksesuar për herë të fundit më 22.07.2024). Anëtarit në detyrë si kryetar Bordi i mbaron mandati më 12.09.2024. Shih linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20210310134338vendim%20nr.%2028%2C%20dt.%208.3.2021.pdf>

78 Kuvendi datë 11.04.2024 ka zgjedhur në pozicionin “anëtar i Bordit të AMF-së që mban detyrën e drejtorit ekzekutiv” nëndrejtorin ekzekutiv të Bordit pa e liruar më parë nga funksioni që mbante. Ligji për mbikëqyrjen financiare parashikon se lirimi i anëtarit të Bordit bëhet me vendim Kuvendi.

79 Shih edhe procesverbalin e KEMIP datë 26.06.2024 fq. 7 në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202407161147386933Komisioni%20i%20Medies%20%2026.06.2024.pdf> lidhur me procedurën e ndjekur nga Akademia e Shkencave për propozimin për anëtar të ISKPKSH (përgjigja e kandidaturës V. Tole ndaj pyetjes së deputetes I. Zhupa lidhur me njoftimin për vendin vakant)

80 Shih shpalljen për vendin vakant në linkun <https://www.kryeministria.al/newsroom/njofitim-per-aplikim-14/> (Aksesuar për herë të fundit më 20.04.2024)

81 Shih rishpalljen për vendin vakant në linkun <https://www.kryeministria.al/newsroom/rishpallje/> (Aksesuar për herë të fundit më 20.04.2024)

Ndonëse ligji organik, në këtë rast, nuk parashikon afat për fillimin e procedurës paraprake përzgjedhëse, referuar kohës së dorëheqjes nga detyra dhe datës së shpalljes së vakancës, është e kuptueshme që kjo e fundit është bërë nga subjekti propozues (KM) menjëherë, pas përfundimit të së cilës është vijuar me fazën e përzgjedhjes nga një komision ad-hoc i ngritur me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të KM-së ndonëse është vetofruar vetëm një kandidaturë. Shpallje në kohë e vendit vakant rezulton të jetë bërë edhe në rastin e kandidaturës për anëtar të Bordit të ERRE-s (për vendin e dytë vakant) si dhe për anëtar të KDRTSH-së. Referuar kohës së shpalljes në faqen e Kuvendit dhe kohës së mbarimit të mandatit rezulton se organet propozuese përkatësisht, Ekipi Përzgjedhës dhe KEMIP kanë respektuar afatin ligjor⁸². Pavarësisht shpalljes në kohë të vakancave ka raste që kandidatura nuk zgjidhet brenda afatit ligjor si p.sh. anëtarët e KLGJ dhe KLP. Shpallja është bërë, sipas përcaktimit ligjor, 4 muaj përpara përfundimit të mandatit të anëtarëve në detyrë (dhjetor 2023), por kandidaturat (nga Avokatia) janë zgjedhur me 7 muaj vonesë (25.07.2024) ndërsa kandidaturat nga shoqëria civile ende jo⁸³.

Respektimi i afatit kohor për shpalljen e vakancave është shumë i rëndësishëm në këtë proces për arritjen e objektivit të përcaktuar nga norma kushtetuese dhe/ose ligjore, që është përfundimi i procesit të zgjedhjes/emërimit të kandidaturës dhe fillimi i ushtrimit të detyrës prej tij, çka përbën interes publik dhe shtetëror. Ai kërkon vëmendje pasi mosrespektimi i tij, ndonëse nuk prodhon pasoja juridike, reflekton mungesë përgjegjësie nga ana e institucionit propozues, njëkohësisht ndikon negativisht në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e vetë institucionit. Nga ana tjetër, boshllëku ligjor, mund të shërbejë si arsye për inicimin me vonesë të procesit dhe për rrjedhojë plotësimin e vakancave përtej afatit të përcaktuar.

82 Mandati i anëtarit në detyrë përfundonte më 13.12.2023 ndërkohë shpallja për vendin vakant është bërë nga Kuvendi përkatësisht më 15.09.2023 dhe 29.04.2024. Shih shpalljet në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202309271508370178Njoffim%20per%20Perfundimi%20i%20Mandatit%20te%20nje%20anetari%20te%20ERE.pdf> <https://www.parlament.al/lajme/1c94bfc4-bfe9-42c9-891d-ccc21820f180> (Aksesuar për herë të fundit më 18.05.2024)

83 Shih shpalljen në linkun <https://www.parlament.al/lajme/912a6c9a-cb43-45de-976c-d1c6fa13387f> dhe <https://www.parlament.al/lajme/9564ad13-9df6-4dda-8a9d-afde23e070d4>

1.2. ZHVILLIMI I PROCESIT PARAPRAK PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURAVE TË VETOFRUARA, NDËRVEPRIMI ME SHOQËRINË CIVILE

Zhvillimi i procesit paraparak për përzgjedhjen e kandidatave të vetofruara është hapi i dytë në drejtim të plotësisimit të vendeve vakante në institucionet e pavarura. Institucione propozuese sikurse KM, e zhvillojnë këtë fazë të procesit sipas rregullave të detajuara që përfshijnë procedurat e kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidatave⁸⁴. Përzgjedhja e kandidatave për vendin vakant parashikohet të kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura dhe publike të konkurrimit, nga organi propozues. Për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes ngrihet një komision ad-hoc (Komisioni i Posaçëm i Vlerësimit të Kandidaturave), i cili kryen vlerësimin e kandidatave të vetofruara në dy faza: vlerësimin e dosjeve të tyre, për të verifikuar nëse ata plotësojnë kriteret ligjore dhe zhvillimin e intervistës së strukturuar me gojë për të vlerësuar kandidatët për njohuritë që zotërojnë në fushën përkatëse.

Ndonëse procesi i përzgjedhjes nga KM parashikohet të jetë i hapur dhe publik, media apo shoqëria civile nuk përfshihen në këtë fazë të procesit.

E njëjta problematikë, e evidentuar edhe në procesin e vitit 2023, rezulton të jetë edhe në Kuvend, kur ky i fundit është edhe në cilësinë e organit propozues. Referuar rregullave të procedurës, Kuvendi bën shpalljen dhe publikimin e vakancës në faqen e Kuvendit në internet për një afat 20 ditor, pas të cilit kandidaturat e vetofruara u bëhen të njohur anëtarëve të Kuvendit me qëllim organizimin brenda 5 ditëve të dëgjësës së hapur publike në mjediset e Kuvendit ku ftohen të marrin pjesë të gjithë deputetët/grupet parlamentare.

84 P.sh. Këshilli i Ministrave nxjerr vendime. Shih VKM nr. 670, datë 7.11.2018 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave" në linkun <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/164/c7bc9acc-b9f9-48c8-9dd5-2bb9defac192> (Aksesuar për herë të fundit më 21.04.2024), VKM nr. nr. 669, datë 7.11.2018 "Për miratimin e procedurave, të kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidatave për t'u emëruar në pozicionin "Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave" në linkun <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/164/c7bc9acc-b9f9-48c8-9dd5-2bb9defac192>. (Aksesuar për herë të fundit më 21.04.2024)

Avokati i Popullit miraton Rregullore. Shih Urdhër nr. 199/2021 "Për miratimin e Rregullores për Procedurat dhe Kriteret për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Komisionerë të AP-së" në linkun <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Urdher%20199,%20date%2009122021%20per%20miratimin%20e%20rregullores%20per%20procedurat%20dhe%20kriteret%20per%20përzgjedhjen%20e%20kandidateve%20per%20komisioner%20ne%20institucionin%20e%20Avokatit%20te%20Popullit.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 21.04.2024)

Kuvendi e parashikon procedurën paraprake përzgjedhëse në Rregulloren e tij, neni 111.

Ka institucione të cilat nuk rezulton të kenë miratuar rregulla të tilla. P.sh. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në rastin kur i propozon Kuvendit kandidaturën për anëtar të Bordit të AMF

Të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin/kandidatët, që do të mbështesin për t'ia propozuar Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.⁸⁵ Nga monitorimet e kryera rezultoi se Kuvendi, ndonëse e ka miratuar në vitin 2019 këtë procedurë paraprake të përzgjedhjes së kandidaturave, në asnjë rast nuk e ka zbatuar plotësisht atë. Kuvendi, në këtë fazë, është mjaftuar vetëm me shpalljen dhe publikimin e vakancës ndërsa seancat dëgjimore publike në funksion të përzgjedhjes së kandidaturave nuk janë zhvilluar në asnjë rast. Pavarësisht shpalljes së vakancës procesi mbetet jotransparent dhe i cunguar.

Praktika të tilla kritike janë ndjekur nga KM në rastin e përzgjedhjes së kandidaturave për vendet vakante përkatësisht në KS dhe KPP, nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe ministri i Financave në rastin e propozimit të kandidaturave për anëtarë të Bordit të AMF etj.

Shoqëria civile është një përbërës thelbësor i çdo sistemi demokratik dhe duhet të njihet e trajtohet si e tillë nga institucionet shtetërore.⁸⁶ Me hapjen e negociatave të pranimit të Shqipërisë në BE, del në pah nevoja e qartë për bashkëpunim dhe koordinim më të ngushtë mes institucioneve publike dhe shoqërisë civile. Nevoja për një komunikim më të mirë dhe të vazhdueshëm të Kuvendit me shoqërinë civile dhe sfidat në përfshirjen e saj në proceset parlamentare kanë qenë temë debati në forume apo takime të ndryshme të organizuara në kuadër të rolit të parlamentit në proceset demokratike në Shqipëri⁸⁷.

Për shkak të ekspertizës që zotëron, kontributi i shoqërisë civile është faktor ndikues në përmirësimin e proceseve demokratike në vend, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien nga ana e institucioneve publike. Domosdoshmëria e bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe vendimmarrësve është e sanksionuar në shumë dokumente si kombëtare⁸⁸ ashtu edhe ndërkombëtare⁸⁹.

Përfshirjes së shoqërisë civile në proceset parlamentare i kushtojnë rëndësi të veçantë edhe organizata ndërkombëtare si Unioni Ndërparlamentar⁹⁰ apo Lëvizja Transparenca Ndërkombëtare⁹¹.

85Neni 111 pika 2 shkronja c - Rregullore Kuvendi

86Shih: progres raportin e KE-së për Shqipërinë viti 2020 fq. 15 cit. në linkun https://integrimi-ne-be.punete-iashtme.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/Raporti-KE_2020_DBE_8.03.2021_final.pdf (Aksesuar për herë të fundit më 05.05.2024)

87Shih <https://parlament.al/lajme/%20ba362eee-8729-4fd8-8202-fca0ba1da07a> dhe https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid0CMzbeSfBGXo6ThPtXHyCQLmYFYdqfuX22C1f4xC9K-KVtZHBsAqeLmqBz8YZ2Qefl&id=100044233729175 Paneli i dytë i forumit ka trajtuar temën "Roli mbikëqyrës dhe gjithëpërfshirës i parlamentit"

88P.sh. Rezoluta "Për njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit" miratuar nga Kuvendi i RSH" (2014)

89Përmendim: Rezoluta e Këshillit të Kombeve të Bashkuara për Hapësirën Qytetare (2013), Udhëzues Praktik për Shoqërinë Civile - Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (2014), Kodi i Praktikës së Mirë për Pjesëmarrjen Civile në Procesin e Vendimmarrjes (2009) - Këshilli i Evropës etj.

90Shih Global Parliamentary Report 2022 në linkun <https://www.ipu.org/resources/publications/reports/2022-03/global-parliamentary-report-2022> (Aksesuar për herë të fundit më 12.05.2024) fq. 381

91Shih Civil society interventions to enhance parliamentary oversight. Transparency International - 2022 në

Referuar Transparency International OSHC-të mund të mbështesin procesin e verifikimit duke hetuar kualifikimin e kandidatëve bazuar në dokumentacionin e paraqitur, si kualifikimet akademike, ashtu edhe historinë e tyre profesionale ose personale, që mund të ndikojnë në besueshmërinë e tyre për të kryer punën në mënyrë efektive, në mënyrë të paanshme dhe transparente⁹².

Përzgjedhja paraprake e komisionerëve të AP shënon rastin e një bashkëpunimi të suksesshëm midis shoqërisë civile dhe këtij institucioni kushtetues dhe një nga shembujt më të mirë të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin zgjedhës/emërues.

Organizimi i procesit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave të vetëofuara referuar përcaktimit ligjor është kryer nga Avokati i Popullit, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut⁹³ (si vëzhgues).

- Së bashku me shpalljen e vendit vakant⁹⁴ institucioni i Avokatit të Popullit ka publikuar edhe shpalljen për shprehjen e interesit nga organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut në përfundim të së cilës janë përzgjedhur 4 OSHC të cilat⁹⁵ kanë marrë pjesë në dëgjimet publike të organizuara nga Avokati i Popullit.
- Ky rast përbën një shembull të shkëlqyer e unikal të modelit të gjithëpërfshirjes, ku përzgjedhja e kandidatëve është zhvilluar në partneritet të vërtetë me shoqërinë civile. Tashmë është normë e pranuar nga të gjithë se pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrje sjell përfitime të shumanshme politike.

Përfshirja e publikut (veçanërisht OSHC-ve) në procedurën paraprake të përzgjedhjes fuqizon transparencën, rrit besimin e tij tek organi propozues, si dhe imponon respektimin e afateve ligjore dhe përzgjedhjen e kandidatëve profesionalë, të pavarur nga politika dhe me integritet të lartë moral.

linkun <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/kproducts/CSO-interventions-to-enhance-parliamentary-oversight.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 12.05.2024)

92 Shih Civil Society Interventions to Enhance Parliamentary Oversight - Transparency International 2022. <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/kproducts/CSO-interventions-to-enhance-parliamentary-oversight.pdf> fq. 8 cit. (Aksesuar për herë të fundit më 12.5.2024)

93 Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit" të ndryshuar⁹⁴).

94 Shih shpalljen për vendin vakant <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/NJOFTIM%20P%C3%8BR%20SHPALLJEN%20E%20DY%20VENDEVE%20VAKANT%20P%C3%8BR%20KOMISIONER%20N%C3%8B%20INSTITUCIONIN%20E%20AVOKATIT%20T%C3%8B%20POPULLIT.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 25.04.2024)

95 Shih njoftimin e bërë nga Avokati i Popullit drejtuar OSHC-ve për të shprehur interesin e tyre për të qenë pjesë e këtij procesi përzgjedhjeje në linkun <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Shpallje-shoqeria%20civile%20%202023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 20.04.2024)

1.3. DËRGIMI I KANDIDATURAVE PËR SHQYRTIM NË ORGANIN E EMËRTESES (KUVENDIN E RSH-SË)/ DOKUMENTACIONI SHOQËRUES DHE AFATI LIGJOR PËR PARAQITJEN E TIJ NË KUVEND

Paraqitja e kandidaturave në Kuvend, është hapi i tretë në drejtim të plotësimit të vendeve vakante në institucionet e pavarura dhe njëkohësisht finalizon procesin nga organi propozues. Referuar rregullave të procedurës, paraqitja e kandidaturave në organin e emërtesës, Kuvendin e RSH-së, bëhet 45-30 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit⁹⁶.

Një praktikë e mirë propozimi (për kandidaturën/kandidaturat) duhet të shoqërohet me aktin përkatës të organit propozues⁹⁷, një relacion shpjegues mbi procedurën e ndjekur, dokumentacionin e plotë administrativ për kandidatët e përzgjedhur si dhe CV dhe dokumentacionin shoqëruar të kandidaturës/kandidaturave.

- Praktikë e tillë (pjesërisht) është ndjekur nga KM për kandidaturën për anëtar të KS⁹⁸, nga AP për kandidaturat e KLGJ⁹⁹ dhe KLP¹⁰⁰ ndërkohë që mbizotërojnë rastet kur dokumentacioni i kandidaturës paraqitet në Kuvend i cunguar dhe jo i plotë.
- Rasti i kandidaturës për anëtar të Bordit të AMF, propozim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (KMBSH) është rasti më flagrant. KMBSH ka depozituar në Kuvend vetëm vendimin e Këshillit pa CV dhe dokumentacion shoqëruar me arsyetimin se kandidatura e paraqitur garon për një mandat të dytë.
- Referuar ligjit organik kandidatura nuk lejohet të jetë anëtar i më shumë se një bordi apo organi vendimmarrës të ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës.¹⁰¹ Mungesa e CV dhe e dokumentacionit shoqëruar pamundëson verifikimin e këtij kushti ligjor. Mungesa e dokumentacionit nuk ka qenë objekt diskutimi as në mbledhjen e komisionit përgjegjës.
- Në disa raste përvoja profesionale e kandidaturës mësohet nga media dhe jo nga Kuvendi.¹⁰²

96Neni 111, pika 3 të Rregullores së Kuvendit

97P.sh. KM me VKM, Presidenti i Republikës me dekret, KMBSH me vendim etj.

98 Shih dokumentacionin e paraqitur nga KM si organ propozues në linkun

https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202402131402028137VKM%205%20-%20Propozim%20Kuvendit%20emerim%20anetari%20te%20Keshillit%20te%20Statistikave_compressed.pdf

99Dokumentacion i papublikuar në faqen e Kuvendit

100 Dokumentacion i papublikuar në faqen e Kuvendit

101Ligji nr. 9572/2006 "Për mbikëqyrjen financiare" të ndryshuar¹⁰¹ neni 5 - Kërkesat për t'u emëruar anëtar i Bordit.

102Shih <https://scantv.al/mimoza-kaci-propozohet-si-drejto-re-e-pergjithshme-e-amf-jeteshkrimi/>(Aksesuar për herë të fundit më 19.05.2024)

Problematikë tjetër në këtë fazë, e identifikuar edhe gjatë procesit zgjedhës/emërues 2023 mbetet mosrespektimi i afatit ligjor në paraqitjen e kandidaturave në Kuvend. Referuar të dhënave monitoruese, Ekipi Përzgjedhës i ka propozuar kandidaturat në Kuvend për dy anëtarë dhe kryetar të Bordit të ERRE më datë 22.02.2024, ndërkohë që mandati i njërit anëtar dhe kryetarit në detyrë përfundonte më 26.02.2024 kurse i anëtarit tjetër më 13.12.2023¹⁰³. Ndërsa KMBSH ka paraqitur kandidaturën për anëtar Bordi të AMF-së më 12.04.2024, ndonëse mandati i anëtarit në detyrë mbaronte më 03.04.2024¹⁰⁴. Edhe në këtë drejtim, kuadri rregullator (Rregullorja e Kuvendit apo ligje organike) është i heshtur dhe nuk parashikon masa me karakter ndëshkues kur afati i paraqitjes së kandidaturave nuk respektohet nga organi propozues. Rezulton se në asnjërin prej rasteve komisionet përgjegjëse parlamentare nuk kanë vënë para përgjegjësisë organin propozues. Edhe në rastin e kandidaturës për anëtar Bordi në ISKPESH komisioni parlamentar (KEMIP) është mjaftuar vetëm me dërgimin e shkresës zyrtare¹⁰⁵ dhe nuk i ka përshkallëzuar masat (p.sh. thirrja në seancë dëgjimore e subjektit propozues për mosparaqitjen e kandidaturave në Kuvend).

Paraqitja në tejkalim të afatit të përcaktuar e dëmton procesin, pasi bëhet shkas për plotësimin me vonesë të vendeve vakante.

103 Shih procesverbalin e komisionit përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin datë 29.02.2024 dhe 15.04.2024 në linket përkatëse <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404161345278960Procesverbal%20dat%C3%AB%2029.02.2024.pdf> dhe <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202405170836490866Procesverbal%20KVPTM%20dat%C3%AB%2015.04.2024.pdf>

104 Shih vendimin e KMBSH në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202405141249118262BSH%20-%20Propozimi%20i%20K.M.BSH%20per%20Bordin%20e%20AMF.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 15.05.2024)

105 Shih mbledhjen e komisionit datë 02.07.2024 në linkun <https://www.parlament.al/live-vod>

2. PROCESI ZGJEDHËS/EMËRUES NË ORGANIN E EMËRTESES- KUVEND

2.1. NJOFTIMI NË SEANCË PLENARE I DEPOZITIMIT NË KUVEND TË PROPOZIMIT PËR ZGJEDHJE/EMËRIM NË INSTITUCIONET E PAVARURA

Me paraqitjen në Kuvend të propozimit për zgjedhje/emërim lind detyrimi për njoftimin e tyre në seancë plenare. Referuar rregullave të procedurës në fillim të seancës plenare, drejtuesi i saj njofton ndër të tjera edhe propozimet e depozituara në Kuvend për zgjedhje, emërim apo shkarkim në institucionet e pavarura¹⁰⁶. Ky detyrim ligjor vjen në kuadër të së drejtës për informim si një nga të drejtat themelore të njeriut. Media dhe publiku i gjerë duhet të informohen në kohë mbi aktivitetin parlamentar me qëllim që të mund të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes. Edhe OSHC-ve që monitorojnë parlamentin duhet t'u sigurohet qasja në informacionin parlamentar, për ta luajtur në mënyrë efektive rolin e tyre si bashkëpunues në fuqizimin e llogaridhënies demokratike të parlamenteve.

Të dhënat monitoruese tregojnë se njoftime të tilla bëhen shumë rrallë¹⁰⁷ dhe se publiku informohet për kandidaturat e propozuara me shumë vonesë¹⁰⁸. Transparenca dhe publiciteti që duhet të karakterizojnë procesin e zgjedhjes apo emërimit janë elementë që kontribuojnë drejtpërdrejt në cilësinë e institucioneve dhe në veçanti në perceptimin dhe forcimin e besimit të publikut tek këto institucione.

2.2. NJOHJA PUBLIKE ME PËRVOJËN PROFESIONALE TË KANDIDATURAVE

Transparenca dhe besimi i publikut në subjektet që kanë pozicione kushtetuese apo në një organ të krijuar me ligj, luajnë rol të rëndësishëm në shtetin e lirë e demokratik. Publiku ka interes të ligjshëm, që përmes transparencës, të informohet më në detaje mbi punën, jetën profesionale dhe veprimtarinë e kandidaturës në fushën ku propozohet. CV dhe dokumentacioni shoqërues i kandidaturave janë informacion me interes publik, në përputhje edhe me kuadrin ligjor për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare. Publiku ka të drejtë të kërkojë e të marrë sqarime nga organi publik (Kuvendi) në lidhje me publikimin e tyre. Megjithëse të dhënat në CV kanë karakter personal dhe për rrjedhojë, ato përfshihen në hapësirën e gjerë që mbron

106Neni 44, pika 3 Rregullore Kuvendi

107Shih procesverbalet e seancave plenar

108Nëse ndjek mbledhjen e komisionit ose në fund të procesit kur kandidatura zgjidhet.

neni 35 i Kushtetutës¹⁰⁹, ato mund të bëhen publike duke i redaktuar më parë ose duke i kërkuar paraprakisht kandidaturës pëlqimin për publikimin e saj.

Ndonëse me akte të brendshme¹¹⁰, Kuvendi e ka të detyrueshëm publikimin e jetëshkrimeve ky i fundit vijon të mos vihet në dispozicion të publikut. Kuvendi, mjaftohet ndonjëherë vetëm me publikimin e një përmbledhjeje shumë të shkurtër të eksperiencës profesionale të kandidaturave dhe këtë e bën në fazën e fundit të procesit¹¹¹, problematikë e evidentuar edhe në procesin e vitit 2023. Kandidaturat për anëtarë dhe kryetar të Bordit të ERRE, KK, AMF etj janë ndër rastet. Raporti i Komisionit Evropian për Shqyrtimin Analitik (Screening) për grup-kapitujt 1, (Themelorët) për sa i përket transparencës thekson se kjo e fundit mbetet kyç për të garantuar që ligjvënësi të jetë i aksesueshëm dhe i përgjegjshëm¹¹² "Përmirësime të mëtejshme mbeten të nevojshme për të siguruar disponueshmëri publike më në kohë dhe miqësore për përdoruesit e dokumentacionit zyrtar parlamentar, për shoqërinë civile, median, palët e tjera të interesuara dhe publikun më të gjerë".

Nga monitorimi rezulton se ka edhe praktika pozitive, sikurse rasti i kandidaturës që garonte për anëtare e Këshillit të Statistikave (KS), praktikë e cila duhet të shërbejë si model për një Kuvend transparent dhe llogaridhënës. CV dhe dokumentacioni shoqërues dëshmojnë nivelin e përvojës profesionale dhe të integritetit për kandidaturat dhe janë notë përcaktuese në besimin e publikut në këtë kategori njerëzish. Publikimi i kësaj praktike¹¹³ tregon se nuk ka pengesë ligjore në këtë drejtim, por se mungon vullneti i Kuvendit për të përmbushur këtë detyrim.

109Neni 35 - Kushtetutë sipas së cilës "Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj".

110 Vendim i Byrosë së Kuvendit nr. 5, datë 12.02.2014 "Për miratimin e Rregullores për funksionimin e faqes zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë" (neni 3)

111 Në disa raste përvojat profesionale të kandidaturave pasqyrohen shumë shkurt në raportin e komisionit përgjegjës parlamentar, pra përpara se të votohen në seancë plenare. Në disa raste si p.sh. anëtari/kryetari Bordit të ERRE-s nuk është publikuar as raporti, as CV, as propozimi i Ekipit Përzgjedhës.

112 Shih progres raporti i KE për Shqipërinë (2023) në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404041324018899Albania%20report%202023.pdf>

113Shih dokumentacionin në linkun

https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202402131402028137VKM%205%20-%20Propozim%20Kuvendit%20emerim%20anetari%20te%20Keshillit%20te%20Statistikave_compressed.pdf (Aksesuar për herë të fundit më 12.05.2024)

2.3. SHQYRTIMI I KANDIDATURAVE NGA KOMISIONI PËRGJEGJËS PARLAMENTAR

Shqyrtimi në komisionin përgjegjës përbën pjesën më thelbësore në këtë proces, pasi lidhet ngushtësisht me verifikimin e plotësimit të kushteve e kriterëve kushtetuese dhe/ose ligjore për kandidim (përfshirë vlerësimin e meritës) proces i cili referuar rregullave të procedurës duhet kryer brenda tre javëve nga paraqitja e propozimit në Kuvend¹¹⁴. Për verifikimin e këtyre elementëve kërkohet transparencë maksimale dhe një aktor shumë i rëndësishëm në këtë drejtim është padyshim shoqëria civile. Përfshirja e OSHC-ve në këtë proces fuqizon transparencën dhe rrit besimin e publikut në institucionin e Kuvendit dhe në sistemin e qeverisjes në përgjithësi. Pavarësisht rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë për përfshirjen e OSHC-ve në proceset parlamentare, këto të fundit nuk rezultojnë të kenë qenë pjesë e tij. Të dhënat monitoruese tregojnë se pjesëmarrja e tyre në seancat dëgjimore me kandidatët nuk realizohet në asnjë rast.

Aktualisht bashkëpunimi dhe ndërveprimi me shoqërinë civile, për sa i përket ushtrimit të funksionit zgjedhës nga Kuvendi, kufizohet vetëm në paraqitjen e kandidaturave të propozuara nga OSHC-të në disa institucione të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj¹¹⁵. Verifikimi i plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidaturave nga komisioni përgjegjës parlamentar vihet në pikëpyetje për sa kohë që shoqëria civile nuk është pjesë e këtij procesi.

Në kuadër të integritit të Shqipërisë në BE progres raporti i Komisionit Evropian 2023 (KE) rekomandon nevojën e përfshirjes së shoqërisë civile në vendimmarrje në mënyrë të vazhdueshme, intensive dhe joformale. Në kuadër të procesit të adresimit të gjetjeve të paraqitura nga KE në raportin e shqyrtimit (screening report) për Shqipërinë, për sa i përket kriterit politik, Kuvendi ka miratuar një plan masash, një ndër të cilat është edhe rritja e numrit të seancave dëgjimore dhe konsultimeve me

¹¹⁴ Neni 111/4 Rregullore Kuvendi

¹¹⁵ Shih Manualin për Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje miratuar nga Byroja e Kuvendit me vendimin nr. 20, datë 20.05.2022 në linkun [https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Manual%20Pjese%20C%88marrjes%20se%CC%88%20Publikut%20One%CC%88%20Procesin%20Vendimmarrjes%20te%CC%88%20Kuvendit%20-%20Copy%20\(2\).pdf](https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/Manual%20Pjese%20C%88marrjes%20se%CC%88%20Publikut%20One%CC%88%20Procesin%20Vendimmarrjes%20te%CC%88%20Kuvendit%20-%20Copy%20(2).pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 20.04.2024)

Konkretisht:

- a) 6 anëtarë të Bordit të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) propozohen nga shoqëria civile;
- b) 10 anëtarë të Bordit të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Shqiptar (KDRTSH) propozohen nga shoqëria civile;
- c) 1 anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) propozohet nga shoqëria civile;
- d) 1 anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP) propozohet nga shoqëria civile;
- e) 1 anëtar në Këshillin e Institutit të Statistikave (INSTAT) propozohet nga shoqëria civile;
- f) 1 anëtar në Bordin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit (ISKK) propozohet nga shoqëria civile;
- g) 2 anëtarë të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) propozohen nga shoqëria civile.

OSHC në komisionet parlamentare gjatë procesit ligjberës, mbikëqyrës/monitorues dhe zgjedhës¹¹⁶. Parashikimi për ta përfshirë shoqërinë civile edhe në ushtrimin e këtij funksioni përbën risi në veprimtarinë parlamentare. Pavarësisht parashikimit, kjo masë në praktikë rezultoi ende e pazbatuar. Është e nevojshme që Kuvendi ta konsolidojë dhe ta shtrijë bashkëpunimin me shoqërinë civile edhe në ushtrimin e funksionit zgjedhës pavarësisht se fuqizimi i këtij funksioni nuk parashikohet si një ndër objektivat strategjike të Kuvendit¹¹⁷.

Gjatë shqyrtimit rezultoi se komisioni nuk kryen hetime për të verifikuar plotësimin e kriterëve ligjore, kualifikimet e kandidatëve, zhvillimin e karrierës apo për ekzistencën (në të shkuarën) të rrethanave që mund të kenë cenuar integritetin e funksionarit publik, procedurë verifikimi për të cilën përgjegjësia kryesore bie mbi relatorin¹¹⁸. Edhe marrja e informacioneve të nevojshme, mbi aspekte të rëndësishme të figurës së kandidatit/kandidatëve, nga Prokuroria e Përgjithshme (në kuadër të dekriminalizimit) apo Autoriteti i Dosjeve (mosqenia e kandidatit bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit përpara vitit 1990) nuk është objekt diskutimi në komision. Këtu ngrihen pikëpyetje lidhur me kohën e marrjes së këtyre informacioneve. Është e domosdoshme që komisioni t'i kërkojë të dhënat përpara zgjedhjes/emërimit.

Shqyrtimi i kandidaturave ezaurohet në një mbledhje të vetme, e cila në shumë raste zgjat pak minuta. Përgjithësisht në fazën e pyetjeve drejtuar kandidaturës angazhohen 1 apo 2 deputetë, në disa raste asnjë pyetje, asnjë diskutim rreth shqyrtimit të kandidaturës. Në raste të tjera mbledhja zhvillohet pa kuorum-in e kërkuar nga Rregullorja¹¹⁹. Kjo tregon një proces sipërfaqësor dhe jo cilësor¹²⁰, problematikë kjo e ndeshur edhe në procesin e vitit 2023. Ka raste kur nga komisioni, mbajtja e seancës

116Raporti KE për shqyrtimin analitik (Screening) për grup - kapitujt 1, (Themelorët). Shih Planin e Veprimit të masave për adresimin e rekomandimeve që i adresohen Kuvendit nga Raporti i Komisionit Evropian për Shqyrtimin Analitik (Screening) për grup-kapitujt 1, (Themelorët) miratuar nga Konferenca e Kryetarëve me vendimin nr. 3, datë 21.02.2024 në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202401121551121256Plani%20i%20veprimit%20per%20adresimin%20e%20rekomandimeve%20p%C3%ABr%20Kuvendin%20nga%20Raporti%20i%20Shqyrtimit%20Analitik%20%28Screening%29%20%20per%20cluster%201.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 25.04.2024)

117Shih Planin Strategjik të Kuvendit për vitet 2020-2025 në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20211025114206vendimi%20dhe%20plani%20strategjik.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 12.05.2024)

118Për të bërë një vlerësim sa më korrekt të kandidaturave, komisioni duhet të kryejë verifikimet përkatëse të mbështetura në informacione zyrtare nga institucionet përgjegjëse dhe ligjzbatuese. Kjo praktikë është ndjekur vetëm për kandidaturat në KLGJ e KLP nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

119P.sh. mbledhja e KEMIP datë 26.06.2024 gjatë seancave dëgjimore me kandidaturat për Bordin e ISKPKSH me 7 deputetë të pranishëm ndërkohë që ky komision ka 20 anëtarë. Shih mbledhjen në linkun <https://www.parlament.al/live-vod>

120Shih procesverbalin e komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202402141542450207Procesverbal%20KEF%20-%205%20.2.%202024.pdf> për kandidaturën e anëtarit të KS dhe në linkun <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202401180802121663Procesverbal%20KEF%20-%2013.12.2023.pdf> për kandidaturën e anëtarit të Bordit AMF;

dëgjimore me kandidaturën konsiderohet si jo e domosdoshme me arsyetimin se garon për një mandat të dytë¹²¹. Raste të tilla janë ndeshur për dy kandidaturat e propozuara përkatësisht nga KMBSH dhe KM për dy anëtarë në Bordin e AMF-së.

Pjesëmarrja e organit propozues, KM-së, në mbledhjen e komisionit është për t'u adresuar marrë parasysh kompetencën e ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin sa vijon: "të kujdeset dhe të ndjekë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin në Kuvend të emërimeve që paraqiten me propozim të Këshillit të Ministrave apo ministrave përgjegjës, si dhe të kujdeset për respektimin e procedurave dhe të afateve ligjore për emërimet që i propozohen Kuvendit nga Këshilli i Ministrave apo ministri përgjegjës"¹²².

Që të jetë efikas dhe i plotë procesi zgjedhës/emërues kërkon angazhim maksimal nga të gjithë aktorët përfshirë median. Nga monitorimi i kryer rezulton se zhvillimi i seancave dëgjimore në komisionin përgjegjës ka qenë edhe në fokus të mediave, të cilat kanë informuar publikun duke kontribuar në fuqizimin e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së qeverisjes¹²³.

Formati i raportit të komisionit përgjegjës parlamentar vazhdon të jetë i pastandardizuar. Mungon informacioni për kriteret ligjore, që duhen plotësuar, se si është zbatuar procedura paraprake përzgjedhëse nga organi propozues, përvoja profesionale e kandidaturës, performanca gjatë seancës dëgjimore, pyetjet e drejtuara dhe përgjigjet e marra, mendimet e anëtarëve të komisionit (por edhe të OSHC-ve, nëse ka pasur) për kandidaturën në fjalë si dhe korrespondenca (nëse ka pasur) me institucione të tjera dhe që kanë shërbyer për vlerësimin e kandidaturave. Nga monitorimi i kryer rezulton se raportet janë joprofesionale¹²⁴. Raporti reflekton cilësinë e procesit.

121 Shih procesverbalin e mbledhjes së komisionit për Ekonominë dhe Financat në rastin e zgjedhjes së anëtarit të Bordit të AMF-së në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202401180802121663Procesverbal%20KEF%20-%2013.12.2023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 15.05.2024)

122 VKM nr. 27, datë 23.1.2019 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin" të ndryshuar" pikat III/16 dhe IV/8 - Fletore zyrtare nr. 6/2019 në linkun <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2019/6/44de555b-2089-43d7-ac51-a9738af441cc> (Aksesuar për herë të fundit më 30.4.2024)

123 Shih: <https://ata.gov.al/2024/04/15/seance-degjimore-me-kandidatet-per-bordin-e-entit-rregullator-te-energji-se-2/>

<https://ata.gov.al/2023/10/18/bardhyl-sejdarasi-propozohet-anetar-i-keshillit-te-statistikave/>

<https://ata.gov.al/2024/02/05/komisioni-i-ekonomise-miratton-kandidaturen-e-kefi-luarasit-per-antare-te-keshillit-te-statistikave/>

<https://ata.gov.al/2023/09/13/komisioni-i-veprimtarive-dergon-per-votim-3-kandidaturat-per-anetar-te-keshillit-drejtues-te-akep/>

124 Shih raportin për zgjedhjen e anëtarit të KS-së në linkun https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202402131402172352Raport%20KEF_Prgj%20-%20K.Luarasi%20Keshilli%20Statistikave.pdf , për zgjedhjen e anëtarit të KDRTSH në linkun

<https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202406280955310960KEMIP-Raport%20komisioni%20p.vendim%20A.Minga-KDRTSH.pdf> etj.

Shqyrtimi në komisionin përgjegjës përgjithësisht kryhet brenda afatit të përcaktuar. Përmeshja e detyrimit për shqyrtimin e kandidaturave në respektim të afatit ligjor siguron vijueshmërinë e procesit dhe kontribuon në plotësimin në kohë të vendeve vakante.

2.4. SHQYRTIMI I KANDIDATURAVE NË SEANCË PLENARE

Kryerja në kohë e procedurave siguron ligjshmëri në zhvillimin e suksesshëm të procesit zgjedhës/emërues dhe e bën atë efikas. Në të njëjtën kohë tregon edhe përgjegjshmëri dhe seriozitet nga organi i emërtesës (Kuvendi). Ndonëse rregullat e procedurës parashikojnë shqyrtimin në seancë plenare të kandidaturave brenda 1 jave nga paraqitja e raportit të komisionit përgjegjës në mjaft raste ato janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati, problematikë e hasur edhe në procesin e vitit 2023. Zgjedhja e kandidaturave për komisioner të AP, anëtar i KK, KDRTSH, KS apo AMF janë ndër rastet më flagrante¹²⁵.

Të dhënat monitoruese tregojnë se shqyrtimi i kandidaturave në seancë plenare fokusohet vetëm në votimin e kandidaturës duke anashkaluar debatin parlamentar, i cili referuar rregullave të procedurës është i detyrueshëm. Kjo tregon mosinteresim të deputetëve për këtë proces duke përcjellë mesazhe jo pozitive tek publiku, por edhe tek partnerët ndërkombëtarë. Procesi, pavarësisht sfidave, duhet të shihet si një proces vazhdimisht në përmirësim dhe të përshkruhet me aspekte pozitive, në mënyrë që parregullsitë që kanë karakterizuar procesin e vitit 2023 të mos përsëriten më.

Nga të dhënat monitoruese rezulton se 3 raundet e votimit për anëtarët e KLGJ dhe KLP janë të pavlefshme për shkak të mungesës së kuorumit prej 2/3 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Referuar jurisprudencës kushtetuese (vendimet 29/2009 dhe 44/2011), por edhe Rregullores së Kuvendit (neni 55) për përcaktimin e kuorumit Kryetari i Kuvendit i referohet vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar.

Kandidaturat që kërkojnë një shumicë të cilësuar për miratim, në këtë rast 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, kërkojnë domosdoshmërisht të njëjtin kuorum, pra (në këtë rast) një kuorum prej jo më pak se 2/3 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Mungesa e numrit të duhur ligjor përbën shkak për pavlefshmëri votimi. Çdo votim i kryer në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin ose Rregulloren e Kuvendit është i pavlefshëm. Drejtuesi i seancës, pasi merr mendimin e Sekretariatit për Procedurat, Votimin dhe

125Kandidaturat për komisionerë të AP janë shqyrtuar në seancë plenare më 21.04.2024, ndonëse raporti i komisionit përgjegjës mban datën 29.06.2023; Kandidatura për anëtar i KDRTSH është shqyrtuar në seancë plenare më 21.04.2024, ndonëse raporti i komisionit përgjegjës mban datën 17.01.2023; Kandidatura për anëtar i KK është shqyrtuar në seancë plenare më 21.04.2024, ndonëse raporti i komisionit përgjegjës mban datën 20.09.2023; Kandidaturat për dy anëtarë të Bordit të AMF janë shqyrtuar në seancë plenare datë 26.07.2024, ndonëse raportet e komisionit përgjegjës mbajnë datat 08.05.2024 dhe 02.07.2024 etj

Etikën, urdhëron anulimin e votimit dhe përsëritjen menjëherë të tij (neni 61, Rregullore Kuvendi). Referuar fletëve të votimit si dhe procesverbaleve të seancave plenare të publikuara në faqen e Kuvendit në internet pjesëmarrja në votim ka qenë si vijon:

PJESËMARRJA E DEPUTETËVE NË VOTIM (KUORUMI)		
RAUNDET	Kandidaturat për KLGJ	Kandidaturat për KLP
Raundi i parë	73 deputetë ¹²⁶	70 deputetë ¹²⁷
Raundi i dytë	71 deputetë ¹²⁸	70 deputetë ¹²⁹
Raundi i tretë	73 deputetë ¹³⁰	72 deputetë ¹³¹

Referuar jurisprudencës kushtetuese “Prania e deputetëve në vendimmarrje sanksionohet në funksion të ushtrimit të funksioneve kushtetuese të Kuvendit. Nga ky këndvështrim, deputetët e pranishëm duhet të marrin pjesë në vendimmarrje në mënyrë që të garantohet ushtrimi i funksioneve kushtetuese të këtij organi. Pjesëmarrja e deputetit në procesin vendimmarrës në organet dhe seancat plenare të Kuvendit, nuk përbën vetëm një të drejtë të tij, por njëkohësisht, dhe një detyrim që rrjedh nga roli i tij si përfaqësues i popullit. Kjo do të thotë që, deputetët të cilët deklarohen të pranishëm në seancë duhet të japin kontributin e tyre në formimin e vullnetit të organit kolegjal, duke votuar sipas përcaktimeve në Rregulloren e Kuvendit” (vendimi nr. 44/2011 GJK). Referuar praktikës sonë parlamentare në shumë raste deputetët opozitarë janë të pranishëm, por nuk marrin pjesë në procesin e votimit. Parlamentet e huaja aplikojnë sanksione financiare të barabarta me ndalesën e pagës së deputetit për atë ditë për mospjesëmarrje në votim. Në këtë kontekst, ISP vlerëson të nevojshëm huazimin e praktikës së huaj parlamentare me parashikimin e sanksioneve financiare ndaj deputetëve jo votues (not voting).

Është për t’u theksuar angazhimi i medias në pasqyrimin e zgjedhjes së kandidaturave në institucionet për të cilat garojnë duke kontribuar në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së qeverisjes.¹²⁶

126Shih zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv të Bordit të AMF-së në linkun <https://newsbomb.al/aktualitet/mimozakaci-miratohet-si-drejto-re-e-pergjithshme-e-amf-i330804> zgjedhjen e anëtarit të KDRTSH-së në linkun <https://shqiptarja.com/lajm/ndricim-xhepaanetar-i-keshillit-drejtues-te-radiotelevizionit-shqiptar-kuvendi-e-voton-me-95-vota-pro-etj>.

3. KONKLUZION

Kuvendi gjatë vitit 2024, në ushtrim të funksionit zgjedhës, ka përmbushur detyrimin ligjor për zgjedhjen e disa kandidaturave të paraqitura. Institucionet që kanë pësuar ndryshime në përbërjen e organit të tyre drejtues (Bord, Këshill) janë: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Instituti i Statistikave, Këshilli Drejtues i Radio Televizionit, Komisioni i Prokurimit Publik, Enti Rregullator i Energjisë, komisionerët e Avokatit të Popullit, Komisioni i Konkurrencës, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë¹²⁷. Ndërkohë, aktualisht, rezulton se një sërë institucioneve të tjera kushtetuese apo të krijuara me ligj prej disa kohësh kanë vende vakante në organet e tyre drejtuese si AP, ISKPKSH, KMD, KLGJ dhe KLP (shoqëria civile).

Problematikat e ndeshura gjatë procesit 2024 janë të ngjashme me ato të vitit 2023 dhe lidhen me mosrespektimin e afateve ligjore në faza të ndryshme të procesit, mospërfshirjen e shoqërisë civile në këtë proces, zhvillimin joefektiv të seancave dëgjimore me kandidatët, mospublikimin e dokumentacionit të kandidaturave me qëllim njohjen e publikut me to si dhe me angazhimin jo të lartë të deputetëve në shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave, tregues këto të një procesi jo cilësor. Mosplotësimi në kohë i vendeve vakante në këto institucione vijon të jetë shqetësimi kryesor.

Procesi në tërësi ka ecur me ritme të ngadalta duke bërë që një sërë vendesh vakante të plotësohen në tejkalim të afatit ligjor ndërsa të tjera ende të paplotësuara. Vonesat dhe politizimi i proceseve të përzgjedhjes i dobësojnë këto institucione të pavarura. Rastet më flagrante janë zgjedhja e anëtarit të KPP me 37 muaj vonesë, zgjedhja e anëtarit të KDRTSH-së me 31 muaj vonesë, zgjedhja e anëtarit të KS me 32 muaj vonesë, zgjedhja e anëtarëve të KLGJ e KLP (nga Avokati) me 7 muaj vonesë, tregues dramatik dhe alarmant i një procesi jo efikas. Bllokimet dhe vonesat në procedurën e emërimeve vijnë të mbeten shqetësim serioz edhe për organizmat ndërkombëtarë¹²⁸.

127 Shih vendimet nr. 21/2024, 22/2024, 23/2024, 24/2024, 30/2024, 31/2024, 32/2024, 33/2024, 38/2024, 39/2024, 44/2024, 45/2024.

128Raporti i Komisionit Evropian (nëntor 2023) për Shqipërinë për shqyrtimin analitik (Screening) për grup-kapitull 1, (Themelorët) nënvizon se "Duhet të adresohen bllokimet dhe vonesat në procedurën e emërimeve nga parlamenti, të titullarëve dhe anëtarëve të institucioneve të pavarura dhe emërimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat që sigurojnë në masën më të lartë të mundshme autoritetin, paanshmërinë, pavarësinë dhe legjitimitetin e institucioneve"

<https://kuvendwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202404041324018899Albania%20report%202023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 12.05.2024)

Arsyet e bllokimit të procesit dhe për pasojë, mosplotësimin në kohë të vendeve vakante janë të ndryshme dhe lidhen kryesisht me ndikimin politik¹²⁹,

problematikat me kuadrin ligjor¹³⁰, mungesën e dakordësisë midis forcave politike në Kuvend¹³¹ apo mungesën e përgjegjësisë së institucioneve të përfshira në këtë proces¹³².

4. REKOMANDIME

Institucionet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj janë me rëndësi kyçe në sistemet demokratike të qeverisjes dhe ky status kërkon vendosjen e standardeve të larta të profesionalizmit dhe integritetit. Është përgjegjësi e Kuvendit që këtë proces ta zhvillojë brenda afateve kushtetuese dhe/ose ligjore duke zgjedhur njerëz profesionistë dhe me integritet. Si institucioni kryesor në jetën politike të vendit, por edhe në procesin e integritetit drejt Bashkimit Evropian (BE), Kuvendi, e ka të domosdoshëm fuqizimin e mëtejshëm të ushtrimit të funksioneve kushtetuese që t'i mundësojnë përballjen me sfidat e hyrjes në këtë organizëm ndërkombëtar.

- Në këtë kontekst, duke parë problematikat e hasura gjatë procesit zgjedhës/emërues dhe duke u qëndruar rekomandimeve të dhëna, ISP vlerëson se Kuvendi duhet të punojë fort për të shmangur faktorët që ndikojnë dukshëm në mosplotësimin në kohë të vendeve vakante si dhe për të pasur qasje pozitive ndaj praktikave dhe kërkesave të BE-së, që të mund të dëshmojë se është gati për t'u anëtarësuar në familjen e madhe evropiane.
- Zhvillimi i procesit zgjedhës në pajtim të plotë me standardet evropiane është faktor i rëndësishëm drejt BE-së pasi dëshmon nivel të lartë transparence, llogaridhënieje dhe përgjegjësie nga Kuvendi, tregues këto të një parlamenti demokratik dhe që shërbejnë si barometër për t'u anëtarësuar në këtë organizëm ndërkombëtar.

129 Po aty. "Konfliktet brenda mazhorancës lënë peng prej muajsh përmbushjen e detyrimeve të Kuvendit për plotësimin e vakancave në këto institucione". Shih Raportin e Komisionit Evropian (2023) për Shqyrtimin Analitik (Screening) për grup-kapitujt 1, (Themelorët): "Megjithatë, këto procese emërimesh shpesh u nënshtrohen negociatave politike ose shtyhen për shumë muaj për shkak të mosmarrëveshjeve politike në Kuvend, duke çuar herë pas here në pyetje mbi autoritetin dhe pavarësinë e disa prej të emëruarve që rezultojnë".

130 P.sh. sipas ligjit nr. 10.242/2010 "Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunitetit në Shqipëri" për çdo vend për anëtar bordi propozohen 3 kandidatë. Në rastet kur nuk plotësohet ky numër organi propozues bën rishpalljen e vendit vakant duke shtyrë procesin.

131 P.sh. mosdakordësi në zgjedhjen e Avokatit të Popullit.

132 P.sh. mosrespektimi afateve ligjore për nisjen e procedurës paraprake nga organi propozues.

ISP vlerëson se shmangia e ndikimit politik, si faktori kryesor, që dëmton rëndë këtë proces, kërkon vullnet politik dhe është një sfidë e madhe për klasën politike në vend.

- Mënyra se si zgjidhen titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese të institucioneve të pavarura mbart mesazhin e nivelit të qasjes në BE. Gjithçka fillon me mënyrën se si zgjidhen këta funksionarë.
- Për të minimizuar sa më shumë ndikimin politik, është e nevojshme dhe e domosdoshme përfshirja e shoqërisë civile në këtë proces. Pjesëmarrja e saj heq barrierat që pengojnë garën e ndershme dhe të drejtë si dhe garanton profesionalizmin e transparencën gjatë përzgjedhjes¹³³. Kjo e bën procesin cilësor.

Mbetet e nevojshme që komisionet përgjegjëse parlamentare të ndërtojnë ura bashkëpunimi me subjektet propozuese për të shmangur çdo pengesë institucionale ose ligjore.

- Ndërhyrjet në kuadrin ligjor përkatës për të parashikuar afate për iniciimin e procesit, masa me karakter ndëshkues për institucionet propozuese në rastet e mosrespektimit të afateve ligjore, apo miratimin nga propozuesi të rregullave të detajuara për zhvillimin e procedurës paraprake të përzgjedhjes ndihmojnë në cilësinë e procesit.
- Hartimi i një ligji kuadër për institucionet e pavarura, ku ndër të tjera të gjejë rregullim edhe procesi i zgjedhjes/emërimit të titullarëve dhe anëtarëve të organeve drejtuese të tyre duke unifikuar dispozitat e ligjeve organike, si dhe krijimi i një sistemi online (software) për monitorimin dhe ndjekjen e plotësisht të vendeve vakante në këto institucione do të fuqizojnë më tej procesin.

¹³³Sikurse praktika bullgare. Shih nenin 90/4 të Rregullores së Kuvendit Kombëtar të Bullgarisë sipas së cilës OSHC (por edhe media) paraqesin opinione dhe pyetje për kandidaturat.

Web: www.isp.com.al
E-mail: contactaips@isp.com.al
Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies
Adresa: Rr. "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë